

1 E mërkurë, 4 shtator 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretar i
6 seancës, mund të paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo është çështja KSC-
8 BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit,
9 Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju
10 faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të akuzuarit
12 janë të gjithë të pranishëm në sallën e gjyqit. Sot do të
13 vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë 01511.

14 Ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
17 Z. Tetaj.

18 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë
20 sot me dëshminë tuaj. Ju rikujtoj të përgjigjeni qartë, me
21 fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht
22 kërkoni që pyetja të përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni në
23 mënyrë që ta sqarojmë.

24 Gjithashtu, na thoni ku e bazoni ju njohurinë, faktet dhe
25 rrethanat për të cilat do ju bëjnë pyetje.

1 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të
2 vërtetën sikurse vetë e thatë përmes betimit solemn.

3 Flisni në mikrofon dhe ju lutem prisni pak përpara se të
4 përgjigjeni dhe flisni ngadalë për përkthyesit.

5 Nëse keni nevojë për ndonjë pushim na thoni dhe do bëjmë
6 organizimin përkatës.

7 Tani do të vazhdojmë me pyetjet nga Mbrojtja e z. Thaçi.
8 Fjalën e ka z. Misetiç. Dëgjojeni me vëmendje.

9 DËSHMITARI: Rrustem Tetaj [Vijon]

10 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç:

11 [Vazhdim]

12 Z. MISETIC: [Përkthim]

13 PY. Mirëmëngjesi sërish, z. Tetaj.

14 PË. Mirëmëngjesi.

15 PY. Dëshmitar, dje po flisnim për takimin e 2 shtatorit ku
16 kanë qenë të pranishëm dhe anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm.
17 Unë dua të tregoj një dokument.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Që është prova materiale me numër
19 1D00102.

20 PY. Dëshmitar, unë do t'ju tregoj një intervistë në gazetën
21 Zëri në nëntor të 1999 që e ka dhënë Bislam Zyrapit pikërisht
22 për atë takim.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqet 8 në të dyja
24 versionet. Shkojmë tek pjesa ku thotë: "Ku u takuat dhe për
25 çfarë folët me Tahir Zemën?"

1 PY. Z. Zyrapi ka thënë kështu:

2 "Takimin e mbajtëm në një shkollë në fshatin Bardhaniq,
3 ku ishte stacionuar edhe brigada. Gjatë takimit ia tërhoqëm
4 vëmendjen Tahirit për faktin se në ushtri nuk bëhet votim nga
5 fshatrat apo nga anëtarët e publikut dhe se emërimet bëhen nga
6 lartë-poshtë. I thashë Tahirit se ai e dinte se si bëheshin
7 emërtimet në ushtri, në përputhje me rregullat e shërbimit.
8 Pra, i thamë atij se komandanti mund të zgjidhej vetëm nga
9 Shtabi Qendror. Pastaj i grumbulluam të gjitha fshatrat së
10 bashku duke përfshirë fshatrat në fjalë dhe pas një mbledhjeje
11 të gjatë i bindëm se nuk kishin të drejtë të votonin dhe të
12 emëronin një udhëheqës ushtarak. Pas mbledhjes me fshatrat u
13 kthyem në takimin në Bardhaniq. Pastaj unë lexova deklaratën e
14 Shtabit Qendror se komandanti i Zonës Operative të Dukagjinit
15 ishte Ramush Haradinaj sipas emërimit të bërë nga udhëheqja e
16 lartë ushtarake dhe se Tahir Zema mund të ishte zëvendësi i
17 Ramushit. Tahir Zema nuk e pranoi postin. Ai kishte aty pranë
18 një telefon satelit dhe telefonoi Ahmet Krasniqin, duke
19 informuar atë për gjithçka që kish ndodhur."

20 E para, po përfundoj për momentin këtu. Ju kujtohet tani
21 çfarë është diskutuar në takimin e Bardhaniqit?

22 PË. Po. E kam cek edhe dje.

23 PY. Përshkrimi i z. Zyrapi për takimin e 1999 a përputhet dhe
24 me atë që ju kujtohet ju?

25 PË. Në disa vende po. Mirëpo kjo është vetëm deklaratë për

1 gazetën Zëri e jo që më bind që unë e kam dëgjue që ka fol me
2 Tahirin në lidhje me bindjen e tina dhe se si zgjidhet
3 komandanti.

4 E dyta, këtu, pas atij takimit, kurrë fshatrat në komunën
5 e Deçanit nuk janë bashkue. Vetëm përpara se me u zgjedh, kur
6 është kanë i zgjedhur Tahir Zema jemi kanë në tubim. Pra, këtu
7 Zyrapin nuk ka shanc që unë mos me e dit që në fshatrat përreth
8 dhe komandantët e fshatrave, shtabeve të fshatrave, siç i
9 quajtshim në atëherë, të jenë mbledh edhe një herë edhe e kanë
10 diskutu këtë rast. Prej këtij takimi më nuk ka pas mbledhje.
11 Sa e di unë.

12 PY. Pra, ju po thoni që ju nuk keni dijeni që të jenë takuar
13 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm me përfaqësuesit e
14 fshatrave?

15 PË. Jo.

16 PY. Kështu?

17 PË. Po de. Po, ashtu është.

18 PY. Më poshtë vazhdon ky artikull dhe thotë:

19 "Pastaj unë dhe Hashim Thaçi folëm me Ahmet Krasniqin në
20 telefon. I thashë Ahmetit, si mund të bësh votim për një
21 komandant kur kemi një shtabi qendror në Kosovë? Ahmeti u
22 përgjigj, 'Ju merruni me punët tuaja dhe mos ndërhyjni me
23 oficerët e mi'. Më pas unë i thashë atij 'Këta janë anëtarë të
24 UÇK-së'. Ai tha, 'Jo, janë të mitë dhe ju s'keni punë të
25 ndërhyjni'."

1 Po ju nuk keni njohuri personale të asaj që është
2 diskutuar mes Bislime Zyrapi dhe Ahmet Krasniqit, apo jo?
3 PË. Bislime s'ka marrë pjesë hiç në ato momente. Vetëm
4 Hashimi dhe Tahiri kanë hi. Bislime Zyrapi ka qenë me ne. E pse
5 e ka thënë ai, ai e din.

6 PY. Pra, ju nuk dini që të ketë qenë dhe z. Zyrapi me z.
7 Thaçi kur kanë folur me Ahmet Krasniqin në telefon satelitor,
8 saktë?

9 PË. Unë e di që ka qenë me Thaçin, po, kur janë ardh. Por
10 kanë fol me Ahmet Krasniqin, kanë qenë vetëm Tahir Zema edhe
11 Hashim Thaçi. Edhe na të gjithë që ishim afër, pak nja, pak ma
12 larg. Ai me ne ka qenë prezent. A fjala "ai" për Zyrapi.

13 PY. Më pas artikulli thotë:

14 "U kthyem në takim dhe i them atij që duhet të
15 qëndronte", domethënë, Tahir Zema, "si zëvendëskomandant i
16 zonës. Ai tha që se nuk do t'i pranonte këto detyra dhe se do
17 të vazhdonte të qëndronte si komandant i Brigadës 131 me bazë
18 në Prapaqan. Ne pastaj vendosëm që ai të qëndronte si
19 komandant i kësaj brigade, por me kusht që të mos ndërhynte në
20 asnjë lloj çështjeje civile siç kishte bërë më përpara."

21 Së pari, a ju kujtohet ju që të jetë kthyer Bislime Zyrapi
22 në takim dhe t'i ketë thënë Tahir Zemajt që ti mund të jesh
23 zëvendëskomandant dhe pastaj Tahir Zemaj nuk e pranoi këtë?

24 PË. Nuk jam kanë në atë takim. Dhe sot po e ndëgjoj për herë
25 të parë.

1 PY. Po të kujtohet ty që Bislam Zyrapi t'i ketë thënë Tahir
2 Zemajt që, "dakord ti mund të qëndrosh komandant i Brigadës
3 131, po mos ndërhy me asnjë çështje civile siç ke bërë më
4 përpara"?

5 PË. Sa jam unë në dijeni, nuk është e vërtetë që i ka thënë.

6 PY. Po ti sapo na the që nuk ishit atje?

7 PË. Kush? Po e di rrjedhën se më ka thënë dhe Tahiri sa ka
8 qenë edhe oficerë të tjerë janë gjallë. Na pas kthimit, pas
9 kthimit të këtyre, na -- a Tahiri është konsultue me Ahmet
10 Krasniqin dhe me ministrin e Qeverisë në Ekzil, Bujar
11 Bukoshin, me telefon satelitor. Pak ma kjart ta keni. Dhe aty
12 na ka ardh urdhni që na mu tërhjek me urdhën të qeverisë.

13 PY. Po pyetjen e kam kështu: Kur të bëra një pyetje pak më
14 përpara, ti u përgjigje dhe the se nuk ke qenë i pranishëm
15 fizikisht në atë takim, saktë?

16 PË. Po, thashë. Po, e vërtetë.

17 PY. Më pas në intervistë ai thotë:

18 "Pas kësaj, siç e dini, filloi ofensiva dhe Tahiri i
19 tërhoqi të gjitha trupat, e la vijën e frontit dhe dorëzoi një
20 arsenal të madh armësh".

21 Tani dua të flasim për tërheqjen e trupave. Gjatë
22 intervistës i thatë ZPS-së se Tahir Zemaj vendosi t'i tërhiqte
23 trupat në përputhje me urdhrin e qeverisë në mërgim e më
24 konkretisht të Ahmet Krasniqit, saktë?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe vendimi për të tërhequr trupat u mor nga Tahir Zemaj
2 së bashku me Ahmet Krasniqin, saktë?

3 PË. Po.

4 PY. ZPS-së i thatë që Zemaj i tërhoqi trupat se premtimet që
5 kishte marrë fillimisht nga qeveria Bukoshi nuk u mbajtën,
6 saktë?

7 PË. Saktë.

8 PY. E më konkretisht i thatë ZPS-së se Zemaj nuk mori
9 furnizime, furnizimet që ia kishte premtuar qeveria Bukoshi,
10 kështu?

11 PË. Shumë e vërtetë. Të gjitha ato premtime që i ka dhënë
12 Bukoshi me Ahmet Krasniqin me hyrjen në frontin e luftës Tahir
13 Zema, neve asnjë ndihmë, asnjë logjistikë s'na ka ardh. Për më
14 i pas ma kjartë, jam deklaruar edhe para Prokurorisë, që me e
15 pas ju ma të kjartë, unë e kam pas një takim tresh me Bujar
16 Bukoshin, me misionin diplomatik amerikan që duhet ajo trakt
17 të gjindet dhe të flitet, Bujar Bukoshi, Ahmet Krasniqi dhe
18 Rrustem Tetaj prej telefonit satelitor. Aty dihen të gjitha.

19 Prandaj, të gjitha ato armët që i ka marrë Ahmet Krasniqi
20 janë blloku në Tiranë. Më kurrkush nuk kanë lëvizë, për shkaqe
21 politike, për shkaqe tjera, nuk e di. Mirëpo, na e kemi pru
22 vendim edhe ka pru edhe qeveria edhe na ka urdhnuar që m'i
23 tërhjek. Se ishin ushtarë, gati 1,500 ushtarë që ishin mbet pa
24 municion. Armët ato të lehta i kishin, por jo armatim të rëndë
25 që po flitet këtu s'kemi pas. Po secili e kishte armët e vogla

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rrustem Tetaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly

Faqe 8

1 në duart e veta ushtarët dhe ne. E ne në ato, na e kemi çu
2 vendimin që na nuk mujm të bëjmë rezistencë. Prandaj për
3 mbrojtjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe ushtarëve u bë
4 tërhekja me vendimin e qeverisë të Republikës së Kosovës në
5 ekzil dhe të Ahmet Krasniqit. Kjo është e tëra.

6 PY. Faleminderit, Dëshmitar. E vlerësoj faktin që ju
7 përgjigje pyetjeve të mia. Nuk kam më pyetje për ju.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
9 Znj. O'Reilly.

10 Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly:

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

12 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

13 PË. Mirëmëngjes.

14 PY. Unë quhem Annie O'Reilly dhe përfaqësoj Kadri Veselin.
15 Kam pak pyetje për ju, jo më shumë se gjysmë ore mbase. Shumë
16 prej temave tashmë janë mbuluar. Sidoqoftë, ka disa aspekte që
17 do të doja t'i rishikonim dhe një herë së bashku shkurtimisht.

18 Dje u diskutua tema e parë, kështu që bëni pak durim, ju
19 lutem. Unë dua të flas për fillimet e organizimit në 1998 pas
20 sulmit që iu bë kullës së Haradinajve më 24 mars 1998.

21 Mesa kuptojmë, ju e filluat organizimin në fshatin Baran
22 shkurtimisht pasi ndodhi ky sulm, saktë?

23 PË. Jo. Baran. Në Gllogjan. Kur u sulmu Gllogjani na e kemi
24 formue shtabin e Gllogjanit, qysh ju kuptova nëse ka qenë
25 përkthimi mirë.

1 PY. Po, Dëshmitar. Po do t'ua tregoj dëshminë që keni dhënë
2 në rastin Haradinaj e vendosim në ekran.

3 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Materiali është It-04-84 T3597-
4 T3689 tek faqja 3626 në anglisht. Ndërsa për shqipen është
5 faqja 32.

6 PY. Unë po përpiqem të flas për organizimin që keni bërë ju
7 në fshatin tuaj si ish-oficer i Armatës Jugosllave, një person
8 që të respektonin për organizim dhe mbrojtje këto ditët e para
9 të pas sulmit.

10 Dhe ju është bërë pyetja -- të shohim një herë në qoftë
11 se jemi në faqen e duhur? Ju është bërë pyetja:

12 "Si u organizua fshati juaj?"

13 Dhe ju thatë:

14 "Siç ju thashë patëm një takim. U përpoqëm të gjenim disa
15 roje, roje nate dhe ata fillimisht nuk kishin armë. Për çdo
16 gjë ju kisha thënë të më raportonin mua. Improvizuam një
17 sistem që të paktën të ruanim rrugët në hyrje, në dalje të
18 fshatit."

19 "PY. A kishit punkte apo pika të organizuara në rrugët
20 që vinin në fshatin tuaj?"

21 Ju u përgjigjët:

22 "Po, këtë thashë. Punkt është fjalë e madhe në fakt për
23 atë që kemi bërë ne. Ne kemi bërë një gjë shumë të thjeshtë,
24 kishim vetëm një roje. Pra, nuk ishte në punkt në kuptimin
25 ushtarak të fjalës."

1 Dëshmitar, ju kujtohet kjo dëshmi në çështjen Haradinaj?
2 PË. Po. Por vetëm nëse më lejohet të flas. Unë Kadri Veselin
3 jashta në televizor edhe sot po e shoh qetu se kurrë nuk e kam
4 pa. Edhe mbasi nuk e kam pa edhe nuk ka qenë edhe në zonën e
5 luftës, ju lutem, unë nuk di çka kam me thënë me të. Këtë e kam
6 deklaruar edhe para Prokurorisë. Vetëm për Hashim Thaçin që jam
7 taku me të edhe Rexhep Selimin në Jabllanicë edhe ato që i kam
8 fol përpara, unë për Jakupin edhe për Kadri Veselin vetëm çka
9 spekuloj ose kam ndi.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
11 nuk po ju bën njeri pyetje për këtë që sapo thatë. Thjesht
12 përgjigjuni pyetjes së znj. O'Reilly që ta përfundojmë
13 dëshminë tuaj.

14 DËSHMITARI: Deshta vetëm një sqarim që s'di dhe çka foli
15 më tutje për të.

16 Urdhno. Të sakta janë këto. Të sakta janë këto që kam fol
17 këtu përpara.

18 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

19 PY. Faleminderit. E di që mund t'ju duket pak e habitshme që
20 po ju bëj pyetje unë. Unë s'do ju bëj pyetje për z. Veseli
21 drejtpërdrejt. Po ka disa informacione shtesë që ne na
22 ndihmojnë me rastin tonë, me çështjen tonë. Kështu që thjesht
23 fokusohuni tek pyetja që të mos e zgjasim më shumë seç duhet.

24 Ju keni thënë gjithashtu ose më saktë keni thënë për
25 faktin që s'kishte armë e uniforma gjatë periudhës së verës.

1 Do t'ju them çfarë keni thënë ju. Ju keni thënë:

2 "Besoj, në fshatin tim, unë kam qenë personi i parë dhe i
3 fundit që të kisha një. Pjesa tjetër e fshatit ishin civilë.
4 Personat që arritën të blinin armë për veten e tyre, i kishin,
5 por ... pjesa tjetër e fshatit ishin thjesht civilë. Unë isha
6 i vetmi person që kisha një uniformë."

7 Ju kanë bërë një pyetje ju:

8 "Po thoni që kështu ka qenë situata deri në momentin që
9 vetë u larguat nga Kosova në shtator?"

10 Ju keni thënë, ti ke thënë:

11 "Po, po flasim për fshatin tim?"

12 Pastaj ju është bërë pyetje:

13 "Po, po. Për fshatin tuaj. Po jua bëj pyetjen kështu --"

14 Ju keni thënë:

15 "Po, në fshatin tim, deri në momentin që u largova. Po,
16 po."

17 Keni thënë disa herë "Po, po, po".

18 "Deri në momentin që u largova nga Kosova me ushtarët e
19 FARK-ut kam qenë i vetmi person me uniformë në fshatin tim."

20 A ju kujtohet ta keni thënë diçka të tillë në gjykimin
21 Haradinaj?

22 PË. Po, më kujtohet.

23 PY. Është e vërtetë? A është e vërtetë?

24 PË. E vërtetë. E vërtetë.

25 PY. Ju keni thënë disa herë dje, po dhe në deklaratat të

1 mëparshme, përfshirë në çështjen Haradinaj, se ka pasur
2 luftime, granatime gjatë gjithë kohës gjatë kësaj periudhe
3 kohore në atë pjesë, në atë territor të Dukagjinit në lindje.

4 PË. Po

5 PY. Saktë?

6 PË. Po.

7 PY. Faleminderit. Flasim tani për krijimin e zonës, zonës siç
8 ishte ajo, më 23 qershor 1998. Kjo është periudha kur është
9 mbajtur dhe takimi që ju kujtohet në Jabllanicë. E thatë dje.
10 Në këtë takim ju keni propozuar Ramushin si komandant.

11 A ju kujtohet kjo që e thatë?

12 PË. E vërtetë.

13 PY. Ramushi nuk ishte oficer i Armatës Jugosllave, apo jo?

14 PË. Drejtë.

15 PY. Ai kishte kryer shërbimin ushtarak por nuk qëndroi që të
16 merrte dhe formimin e oficerit. E dini këtë?

17 PË. Kam dëgjue. Po.

18 PY. Dhe ndonëse ju ishit një oficer i armatës Jugosllave, një
19 ish-oficer, ju e dhatë pëlqimin për pozitën e tij, apo jo? E
20 mbështetët kandidaturën e tij?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk u
22 përgjigj dëshmitari.

23 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

24 PY. E mbështetët kandidaturën e tij? Na falni, Dëshmitar, se
25 nuk u dëgjua përgjigja juaj. A e përkrahët ju kandidaturën e

1 tij si komandant të zonës së Dukagjinit?

2 PË. Po.

3 PY. Në fakt, në zonën e Dukagjinit në këtë momente qQveria
4 Bukoshi, e konkretisht Krasniqi, nuk është se kishin dhënë
5 ndonjë kandidat, apo jo?

6 PË. Jo.

7 PY. Ishte Ramushi ose Lahija, dy persona të zonës aty edhe ju
8 mbështetët Ramushin, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Në rregull.

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Shohim dokumentin 1D185. Shohim
12 faqen 4 në anglisht dhe faqen 5 në shqip. Desha t'ju pyesja
13 për këtë listën, listën e emërimeve, ta shfaqim qartë në ekran
14 ju lutem.

15 PY. Folëm pak për këtë dje, po tre gjëra janë interesante për
16 mua këtu. Këtu është edhe emri juaj si zëvendës i shtabit të
17 Sali Veselit. E shihni emrin tuaj?

18 PË. Po.

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Anglishtja, ju lutem, faqja
20 tjetër. Ose mbas pak më poshtë.

21 PY. Na falni, Dëshmitar, sa ta gjejmë faqen e duhur.

22 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Në rregull.

23 PY. Shohim këtu që emri juaj është vendosur këtu si zëvendës
24 i shefit të shtabit. Pastaj kemi Skënderin këtu tek njësia
25 anti-blindë. Kush është Skënderi e dini? Kush është Skënderi?

1 PË. Mu më duket është fjala për Skënder Rexhahmetaj, oficer.

2 PY. Më pas në fund shohim mbrojtje kimike dhe biologjike,
3 Muhamet Berisha. Besoj se ju thatë që nuk e dini se kush është
4 ky persona, apo jo?

5 PË. Muhamet Berisha? Kurrë s'e kam pa. S'e di kush është.

6 PY. Na shpjeguat që këto emërime kanë qenë thjeshtë formale,
7 apo jo?

8 PË. Në takimin e Jabllanicës, qetu që po i shoh, në anë me
9 dorë të shkruara janë kanë që në propozimin e atyre që kanë
10 qenë aty, me prokumacion me dorë janë zgjedhë struktura e
11 shtabit të Rrafshit të Dukagjinit.

12 PY. Po. Pra, është bërë me një lloj zgjedhjeje në thelb, këtë
13 po thoni, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Ju thatë se ndërkohë që ju u caktuat si zëvendës, u
16 emëruat si zëvendës shef shtabi, në fakt, në realitet ju
17 thjesht u morët me logjistikën me ngritjen e kazermës siç
18 duhet. Ju kujtohet që keni thënë këtë?

19 PË. E vërtetë.

20 PY. Dhe kazerma në Prapaqan ishte objekti i vetëm i
21 përshtatshëm për stërvitje, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe Ramushi në thelb ia dhuroi brigadës së Tahir Zemajt
24 kur është hy aty, apo jo, pra, ia lejoji brigadës së Tahir
25 Zemajt që të merrte kontrollin e kazermës?

1 PË. Po. S'kishte kundërshtime.

2 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Tani t'u kthehemi këtyre
3 emërimeve. Skënder Rexhahmetaj.

4 PË. Rexhahmetaj.

5 PY. Ai në thelb, pra, në mënyrë efektive nuk ishte marrë
6 kurrë, nuk është se u morr kurrë me luftën kundër njësive të
7 blinduara, lufta kundër tankeve të themi? Nuk ishte diçka me
8 të cilën merrej UÇK-ja aso kohe, apo jo?

9 Ju lutem, të dëgjojmë dhe përgjigjen tuaj që ta kemi për
10 transkriptin, Dëshmitar.

11 PË. Po. Shiqo, ne këto emërime i kemi bë në bazë të asajna që
12 tu mendue që pas një kohe furnizohemi me armatim të rëndë.

13 Prandaj nëse na vojnë tenkat atëherë e kemi pas njërin e duhur
14 që e udhëheqë njësitin tankist. E ai ishte Skënder

15 Rexhahmetaj. Por mjerisht nuk kem pas, s'kemi pas tenka.

16 PY. Po, vërtetë në çështjen kundër Haradinajt ju keni
17 përshkruar se kjo ishte e pakuptimtë, domethënë, që mbledhja
18 në vetvete ishte e pakuptimtë. Mund të na e shpjegon,

19 domethënë, a do pajtoheshit edhe sot me këto fjalë?

20 PË. Zgjedhja si zgjedhje është e mirë për strukturat nën ne,

21 për hir që me pas besim populli. Por faktikisht emërimet që
22 ishin kësisoj u duhshin armatime, u duhshin formacione të

23 rregullta të një ushtrie për me mujt me i bë të gjitha q'ato

24 edhe me i plotësu me kuadro. Na s'kishim tjera kuadro vetëm

25 q'ta që ishin, për ato momente po foli pa ardh Tahir Zemaj. Po

1 na gjithmonë me shpresë që diçka do të ndodh. Ishte një moral
2 shumë i madh.

3 Edhe një herë, po ju them që unë jam ka foli që kam marr
4 pjesë në pesë beteja në Rrafshin e Dukagjinit aso kohe, unë
5 vetë. Pa këta, pa ardh Tahir Zemaj. Edhe mbasi është ardh
6 Tahir Zemaj. Domethënë, i kam pesë beteja si ushtarak me
7 q'ato. Po ka qenë një moral shumë i fortë.

8 Por ardhja e shtabit edhe këtë du, jo du ta cekni, ardhja
9 e Shtabit të Përgjithshëm na ka shkaktu dëme si në furnizim,
10 si në moral, si të gjitha.

11 PY. Dëshmitar.

12 PË. E këtë du ta cekni për shka dhe po foli.

13 PY. E kuptoj.

14 PË. Për atë kohë. Për atë kohë.

15 PY. E kuptoj, ka qenë një periudhë e komplikuar.

16 PË. Po.

17 PY. Patjetër. Do t'ju lexoj dhe një pasazh të fundit nga
18 transkripti çka keni thënë ju në gjyqin kundër Haradinajt.
19 Edhe të na thoni sot nëse vazhdon të jetë e saktë edhe sot. Ju
20 keni thënë:

21 "Se në realitet, më vjen keq që e them këtë, por në
22 realitet e kam thënë dhe dje ne përdornim shumë fjalë si
23 'shtab', 'komandë', 'komandant'. Këto janë thjesht tituj,
24 fatkeqësisht. Nuk është se dua t'ia ul vlerën asaj që bëmë si
25 UÇK, por e kemi fillu nga zero. Ideja ishte e mirë, por në

1 thelb këto ish in gjëra fiktive për momentin atëherë."

2 U qëndroni këtyre fjalëve edhe sot? Janë fjalët tuaja që
3 keni thënë në gjyqin kundër Haradinajt. Mjafton një po ose jo?
4 PË. Po për me e fol të vërtetën e kisha fol, por ajo aso kohe
5 ka qëndruar, ai qëndrim i imi po qëndron edhe sot sepse unë
6 vetë kur ti --

7 PY. Në rregull. Faleminderit, Dëshmitar.

8 PË. Jo, jo. Jo, më jep -- atëherë jetë [E pakuptueshme].

9 Atëherë opinionin nuk e di çka kam fol ose s'po foli.

10 PY. Në fakt, Dëshmitar, nuk mund, unë thjesht po bëj pyetje.
11 Po përpiqem që të shfrytëzoj kohën që më lejon Gjykata.

12 Po të shohim këto lista që kemi para nesh në shqip dhe në
13 anglisht, Faton Mehmetaj këtu përmendet si shërbimi
14 informativ. Këtu --

15 PË. Ku a?

16 PY. -- herë pas here e kemi parë dhe me ZKZ, që në fakt është
17 zbulim-kundërzbulimi. Është diku te mesi i listës.

18 PË. Fatoni q'tu [E pakuptueshme].

19 PY. "Shërbim informativ." E shihni?

20 PË. Po. Po, e gjeta. Po, e gjeta.

21 PY. Dëshmitar, a mund të na e shpjegoni neve dallimin midis
22 shërbimi informativ dhe zbulimit, ZKZ-së?

23 PË. Sipas meje, shërbimi informativ ka të bëjë me informatat
24 të gjitha që merren në terren dhe rrjedhat e luftës dhe
25 problemet e luftës të gjitha që në mënyrë ai me informue

1 opinionin edhe mjetet e informimin edhe vetë shtabin në i cili
2 është. Kjo është ajo e informimit.

3 Sa i përket zbulimit, ai duhet të shikon dhe t'i zbulon
4 të gjitha forcat serbe, forcat e armikut, më fal, forcat e
5 armikut sesi ku gjinden, çfarë njësish ka, çfarë armatimi ka.
6 Çdo gjë që është në mesin e tyre, kështu që me i informue
7 komandantin. Mirëpo, Faton Mehmeti të gjitha periudhat ka qenë
8 *joker*, kurrkush nuk e ka ditë çfarë roli ka. Herë andej herë
9 këndeje, gjithë punët është hi e përzi pa kurrfarë funksioni.
10 Funksion me shkrim po, po vetë i dytë u end ka ka dasht. Nuk e
11 di çka ka bë. As e din as Ramushi, as unë, as e dinë as këta që
12 janë këtu. Kjo është qëndrimi jem për këtë person.

13 PY. Po. Faleminderit, Dëshmitar.

14 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Ju lutem të shohim dokumentin
15 SPOE00225760 në anglisht dhe në shqip, ju lutem.

16 PY. Ky dokument do të na çojë përpara dhjetë ditë në kohë, në
17 2 korrik të 1998. Është një dokument i nënshkruar nga Ramush
18 Haradinaj, do ta shohimja edhe pak.

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Mund të shohim, po, në pjesën e
20 poshtme shohim nënshkrimin dhe datën.

21 PY. Dhe këtu thotë, pra, siç e shikoni, Dëshmitar, i
22 drejtohet Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Thotë:

23 "Kjo është, pra, t'ju informojmë, ju njoftojmë se në
24 mbledhjen e datës 23 qershor 1998 që u mbajt në Jabllanicë u
25 zgjodhën komandanti i shtabit operativ të Rrafshit të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rrustem Tetaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly

Faqe 19

1 Dukagjinit, zëvendëskomandanti, kryeshefi i shtabit dhe
2 zëvendëskryeshefi i shtabit", që jeni ju. Dhe pastaj këtu janë
3 emrat tuaj.

4 A do të pajtoheshit me mua nëse do të thosha se kjo
5 tregon se Shtabi i Përgjithshëm, siç e dini edhe ju, s'kishte
6 të bënte fare, s'kishte gisht fare në mënyrën sesi ishte
7 formuar zona e Dukagjinit. Kjo u krijua në mënyrë lokale nga
8 vetë njerëzit e Dukagjinit, kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Faleminderit.

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Kërkoj që ky dokument të
12 pranohet në prova gjyqësore, ju lutem.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
14 kundërshtim?

15 Z. QUICK: [Përkthim] Jo, nuk kemi asnjë kundërshtim.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Numri
17 SPOE00225760, në shqip dhe në anglisht pranohet.

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo merr numrin e provës
19 materiale 2D0026, klasifikuar si konfidenciale. Faleminderit.

20 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Dhe kam dhe një temë të fundit
21 për të cilën dua të flas me ju shumë shkurt dhe ka të bëjë me
22 Sanije Balajn. Ju kujtohet se kush është Sanije Balaj?

23 PË. Nuk e kam njoft. Po është një vajzë nga Strellci. Kemi
24 pas edhe të gjithë, nuk po du tashti me i kujtu ato, por të
25 gjitha qato ça po shkrun, pajtojna në të njëjtën deklaratë. Se

1 meqë ato deklarata janë kanë edhe në gjyqin e Ramush Haradinit
2 dhe dëshmitar i hapur. Prandaj po ma kujtoni kohën se kur po
3 flitni për qeto gjena, po kujtoj se po gjykohet Ramushi. E jo
4 Shtabi i Përgjithshëm i vetëquajtur i Ushtrisë Çlirimtare të
5 Kosovës.

6 Prandaj çdo gjë që kam thënë, për me shkurtue, ekziston
7 edhe për atë edhe Ramush Haradini --
8 PY. Në rregull. Faleminderit. Pra, për të na rikujtuar të
9 gjithëve këtu, për t'u kujtuar të gjithëve se çfarë keni thënë
10 ju në P93, faqen U002008 ju thatë se:

11 "Faton Mehmetaj dhe një tjetër --

12 PËRKTHYESI: Përkthyesi s'e kapi emrin.

13 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

14 PY. -- janë të përfshitë në këtë krim. Pretendohet se Mete
15 Krasniqi dhe të tjerë kanë arrestuar dhe e kanë ndaluar atë me
16 urdhër të Faton Mehmetajt."

17 A keni lexuar ndonjëherë ju në fakt dokumentin e
18 aktgjyqimit, vendimit, pra, që ka dalë në çështjen kundër
19 Haradinajt?

20 PË. Jo. Veç e di që është i lirë. Dhe ka marrë formën e
21 prerë.

22 PY. Po. Dua të fokusohemi tek pjesa tek Sanije Balaj, jo tek
23 Ramushi. Ka dy aspekte për të cilat do të doja që të flisnit.
24 Aktgjykimi në fakt, flet gjerësisht për vrasjen e saj.

25 Në fakt Trupi Gjykses ka identifikuar se dikush i quajtur

1 Galani ka qenë përgjegjës për vrasjen e saj. Ju kujtohet një
2 seancë përgatitore Shënimi Përgatitor - që është P1595, faqja
3 2, paragrafi 8 - ku ju përmendni Alush Agushin që mund të jetë
4 Galani. Ju kujtohet kjo?

5 PË. Jo, nuk më kujtohet.

6 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Ju kujtoj ta nxjerrim në ekran
7 P1295. Faqja 2, paragrafi 8, ju lutem.

8 PY. Dhe përmendni se kush kanë qenë të pranishëm në këtë
9 takim dhe diku nga gjysma thuhet:

10 "W01511 nuk është i sigurtë nëse Alush Agushi, i cili ai
11 beson se quhej Galani ishte apo jo i pranishëm në këtë takim."

12 Jua rifreskon kjo kujtesën?

13 PË. Po, ashtu është. Më kujtohet, unë s'e kam njohur këtë
14 persona, por mesa duket Galan nuk ka pas ky pseudonimin.

15 PY. Në aktgjykimin e gjyqit kundër Haradinajt e identifikon
16 Galanin që quhej Idriz Gashi.

17 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Është paragrafi 337 i atij
18 aktgjykimi.

19 PY. Po tani jua rikujton kjo?

20 PË. Nuk e di. Nuk mundem kurrgjë me shtu këtu. Nuk e di.

21 PY. A jeni në dijeni që ai është shpallur fajtor në gjykatat
22 brenda vendit për këtë vrasje?

23 PË. Për cilën është fjala? Konkret për cilin?

24 PY. Idriz Gashi është shpallur fajtor për vrasjen e --

25 PË. A ja se a fjala -- e di që një --

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
2 znj. O'Reilly edhe Dëshmitar, po flisni po mbivendosni mbi
3 njëri-tjetrin, nuk po prisni që të mbarojë njëri dhe tjetri
4 dhe për ne është e vështirë të kuptojmë. Rifillojeni nga e
5 para duke bërë pauzë.

6 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, a jeni në dijeni se Idriz Gashi ndryshe i
8 quajtur Galani është shpallur fajtor për vrasjen e Sanije
9 Balajt?

10 PË. Po, jam në dijeni dhe që a mbajt një gjyq, por të njëjtin
11 person nuk e kam njoh.

12 PY. Gjëja e dytë për të cilin desha t'ju bëj pyetje, në të
13 gjitha trupat -- gjatë gjithë diskutimit të Trupit Gjykues për
14 këtë vrasje dhe ka dy aktgjykime për këtë, a jeni ju në dijeni
15 që e vetmja lidhje që bëhet me Faton Mehmetajn është dhënë nga
16 ju, pra, ju e keni bërë këtë lidhje me këtë person? Mjafton të
17 thoni po ose jo.

18 PË. Jo. Duhet me sqarue lidhjen me Faton Mehmetajn e ka për
19 shkak të funksionit tina informativ.

20 PY. Dëshmitar, ju bëra një pyetje shumë të thjeshtë. Ju
21 kërkoj ndjesë.

22 PË. Po.

23 PY. A jeni në dijeni se ju jeni i vetmi person i përmendur në
24 këto aktgjykime që e ka lidhur vrasjen e Sanije Balajt me
25 Faton Mehmetajn?

1 Z. QUICK: [Përkthim] Kundërshtim, të nderuar Gjykatës. Si
2 mund ta di dëshmitari këtë gjë?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
4 nëse e dini përgjigjen e pyetjes mund të përgjigjeni.

5 DËSHMITARI: Jo. Jo, nuk jam në dijeni.

6 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

7 PY. Dhe meqenëse nuk e keni lexuar ju vetë aktgjykimin, ta
8 lexoj unë se çfarë ka konstatuat Trupi Gjykues. Trupi Gjykues
9 ka thënë se Sanije Balaj është vendosur në shënjestër nga
10 persona të cilët nuk kanë vepruar nën urdhrat apo udhëzimet
11 apo nën politikën e UÇK-së dhe se ajo nuk është vrarë kur ka
12 qenë e ndaluar nga UÇK-ja.

13 Prandaj edhe Trupi që e ka bërë rigjykimin nuk mund të
14 arrinte në përfundimin se kush ka qenë përgjegjës për vrasjen
15 e saj.

16 Jeni në dijeni të këtyre përfundimeve nga trupat
17 gjykuese?

18 PË. Jo

19 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

20 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Unë kaq pyetje kisha.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 znj. O'Reilly.

23 Z. Roberts, fjala është për ju.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit. Unë nuk kam asnjë
25 pyetje në këtë moment.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Z. Ellis?

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Kam disa pyetje, po do
4 të jenë të shkurtra.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
6 vazhdoni.

7 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

8 Z. ELLIS: [Përkthim]

9 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Më quajnë Aidan Ellis, përfaqësoj
10 z. Jakup Krasniqi.

11 PË. Mirëmëngjesi.

12 PY. Ju e keni konfirmuar sot, në rreshtin 17 të transkriptit
13 paraprak, në faqen 9 të tij, se ju do të spekulonit nëse do të
14 thoshit çfarëdolloj gjëje në lidhje me Jakup Krasniqin ngaqë
15 ju nuk jeni takuar me të, nuk e keni parë gjatë konfliktit,
16 kështu?

17 PË. Fakt.

18 PY. Në mënyrë që unë të jem i qartë për datat, a është e
19 vërtetë se midis mesit dhe fundit të prillit të vitit 1998 ju
20 keni shkuar në Gllogjan për t'u kyçur në UÇK?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe më datë 8 shtator të vitit 1998, ju e keni lëshuar
23 zonën e Dukagjinit?

24 PË. Po me vendim të qeverisë së Republikës së Kosovës.

25 PY. Po, e kuptoj. Dëshiroj që të shohim një paragraf nga

1 seanca përgatitore që keni bërë me Prokurorinë.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Dokumenti P1595, faqja 6, paragrafi
3 21, ju lutem. Nëse mund ta nxjerrim në ekran. Faleminderit.
4 PY. Është vetëm në anglisht, kështu që unë po e lexoj ato
5 pjesë që më interesojnë. Këtu thuhet:

6 "W01511", që jeni ju, "se Mehmetaj i tha atij se ishte
7 shumë i afërt me Jakup Krasniqin në vitin 1998 kur Jakup
8 Krasniqi është emëruar zëdhënësi publik."

9 Sa i takon datës, besoj bëhet fjalë për mesin e qershorit
10 të vitit 1998 kur Jakup Krasniqi është emëruar si zëdhënësi i
11 UÇK-së, është kështu?

12 PË. Po, ishte në media dhe kështu që kemi pas aso bisedash,
13 por pa Jakup Krasniqin nuk e kam pa.

14 PY. Dhe na keni thënë tashmë se Faton Mehmetaj ishte një
15 *joker*. Edhe sot ju më duket se e thatë diku në faqen 17, pra,
16 që ishte *joker*, kështu?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe është po kështu e vërtetë që nuk keni besim,
19 domethënë, tek Faton Mehmetaj, kështu?

20 PË. Nuk kam besim se në të gjitha strukturat ku kemi qenë si
21 në shtab, si andej, të gjitha ka qenë prezent edhe i paftum.
22 Po pse u bë kjo, nuk e di.

23 PY. S'e keni parë asnjëherë Faton Mehmetaj me Jakup Krasniqin
24 së bashku, që ata të jenë bashkë?

25 PË. Kurrë.

1 PY. As e keni parë, as e keni dëgjuar Faton Mehmetajn që të
2 flasë në telefon me Jakup Krasniqin, apo jo?

3 PË. Jo.

4 PY. Dhe e thënë thjesht, nuk mund të konfirmoni ju vetë
5 personalisht nëse Faton Mehmetaj ka qenë apo jo në kontakt me
6 Jakup Krasniqin, apo jo?

7 PË. Jo.

8 PY. Dhe ju e keni konfirmuar më herët sot, në faqen 17 të
9 transkriptit paraprak, se ju jeni të sigurtë që personat në
10 këtë Gjykatë nuk e dinë se çfarë ka bërë ai, Faton Mehmetaj,
11 gjatë luftës dhe këta persona që janë këtu në Gjykatë
12 përfshijnë dhe Jakup Krasniqin, apo jo?

13 PË. Unë, mu ma merr mendja që nuk e dinë. Por mund të jetë
14 ajo që nëpërmes këto mjeteve telefonike sa kanë pas kontakte
15 këta e dinë. Po sa e di unë, përpos që Faton Mehmetaj më ka
16 thënë që jam në kontakt me të, gojarisht, në atëkohë, fort
17 mirë më kujtohet. Se ish aktuale vetë zgjedhja si zëdhënës i
18 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më tutje nuk e di kontaktet e
19 tyre me Faton Mehmetin.

20 PY. Nëse z. Mehmetaj thjesht po mburrej apo jo, a nëse po të
21 thoshte të vërtetën ju nuk mund ta dini, apo jo?

22 PË. Jo, s'di.

23 PY. Faleminderit.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Unë kaq pyetje kisha, të nderuar
25 Gjykatës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
2 z. Ellis.

3 Z. Quick, keni pyetje plotësuese?

4 Z. QUICK: [Përkthim] Jo, faleminderit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kolegu,
6 Gjykatësi Barthe.

7 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
9 pushimin pesë minuta më herët në mënyrë që të mos fillojmë
10 pyetjet e t'i ndalojmë menjëherë.

11 Do bëjmë tani një pauzë prej 20 -- jo, prej dhjetë
12 minutash. Mund të dilni nga salla do ju shoqërojë Asistentja e
13 sallës.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu
16 ndërprerjen e seancës për dhjetë minuta.

17 --- Seanca ndërpritet në orën 09.55

18 --- Seanca rifillon në orën 10.06

19 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
20 sillni dëshmitarin në sallë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
23 tani kanë disa pyetje anëtarët e Trupit Gjykses. Do të
24 fillojmë me pyetjet e Gjykatësit Barthe.

25 Pyetje nga Trupi Gjykses:

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.

2 PË. Mirëdita.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Besoj më dëgjoni mirë

4 PË. Po, mirë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

6 Trupi Gjykses ka disa pyetje për ju që mendojmë se kanë
7 nevojë për sqarim të mëtutjeshëm. Pyetjet e mia lidhur me
8 shënimet e përgatitura prej Prokurorisë në vijim të seancës
9 përgatitore që keni pasur bashkë. Do të doja të fillonim me
10 Shënimin Përgatitor nr. 1 që u pranua dje dhe mori numrin e
11 provës P1595.

12 Do të ishte më mirë që këtë dokument ta vendosim në
13 ekran. Ju lutem, shkoni në paragrafin 6. Është në faqen e
14 dytë.

15 Dëshmitar, teksti është vetëm në anglisht po unë do t'ua
16 shpjegoj se çfarë është shkruar në këtë raport. Sipas këtij
17 paragrafi në këtë shënim, ju keni diskutuar me Prokurorinë tri
18 subjektet e ndryshme; shtabi i Glllogjanit, shtabi i Rrafshit
19 të Dukagjinit; dhe Shtabi i Përgjithshëm. Dhe sipas këtij
20 shënimi ju i keni thënë Prokurorisë që e kishit dëgjuar që
21 ekzistonte Shtabi i Përgjithshëm, por mendonit se ishte
22 thjesht fiktiv. Se ti personalisht s'i ka parë ndonjëherë me
23 sytë e ty deri në takimin e Zhabelit.

24 Pyetja ime e parë është kjo: Kur ke mësuar për herë të
25 parë që ekzistonte në fakt Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, apo

1 UÇK-ja?

2 PË. Në takimin e Zhabelit.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni për
4 procesverbal kur ka qenë ky takim?

5 PË. Me q' to data [E pakuptueshme] me data nuk e die. E kam
6 harrue. Bile disa herë u përsërit, por takimi në fshatin
7 Zhabel kur ka ardh Hashim Thaçi me na i tregu detyrat e reja.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ka qenë në gusht ose shtator
9 1999 -- 1998?

10 PË. Në gusht, më duket. Në gusht. [E padëgjueshme].

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më falni, po vazhdoni.

12 PË. Sa jam unë në dijeni, në gusht, e jo në shtator. Ka qenë
13 në fund të gushtit, në fillim të gushtit -- në mes të gushtit.
14 Aty diku.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sipas fjalisë së fundit që
16 thuhet në paragrafin 6, i keni thënë Prokurorisë që nuk e keni
17 pranuar Shtabin e Përgjithshëm, as i ke besuar atëherë e as
18 nuk u beson tani. Do të doja të dija për cilët anëtarë të
19 Shtabit të Përgjithshëm e ke pasur fjalën këtu?

20 PË. Jo, unë e kam pas fjalën për Shtabin e Përgjithshëm të
21 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, se unë edhe i besoj vetëm
22 shtetit të Kosovës dhe qeverisë dhe institucioneve të Kosovës
23 të asaj kohës. Po foli për periudhën e luftës. Se në Shtabin e
24 Përgjithshëm janë ndrrue disa emna për një vjet. Dhe nuk
25 mundna me e dit sa njeri shkon në Shtabin e Përgjithshëm të

1 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Shumë emra janë lakue. E nuk
2 po folim vetëm për këta që janë këtu, por në përgjithësi.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pra, e keni
4 fjalën -- e keni pasur fjalën për Shtabin e Përgjithshëm si
5 institucion, nuk e keni pasur fjalën me emra konkretë, këtë po
6 thoni?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptova. Shohim paragrafin
9 8 të Shënimit Përgatitor nr. 1. Në këtë paragraf ke folur për
10 një takim në Jabllanicë me përfaqësuesit e tri fshatrave,
11 Faton Mehmetaj, Lahi Brahimaj dhe Pjetër Shala. Pra, edhe këta
12 kanë qenë të pranishëm në atë takim. Dhe ju keni thënë, sipas
13 shënimit i keni thënë Prokurorisë se kishit dëgjuar fjalë
14 përpara këtij takimi se ishin rrëmbyer persona dhe ishin çuar
15 në Jabllanicë. Dhe keni dëgjuar që ka pas edhe një shtab lokal
16 të UÇK-së në Jabllanicë.

17 Të kujtohet që ja ke thënë këtë Prokurorisë gjatë seancë
18 përgatitore?

19 PË. Po, më kujtohet, sepse secili fshat e ka pas shtabin e
20 vet lokal, një arsyeja. E dyta, të gjitha q'to që ndaloheshin
21 e këto i kam ndëgju vetëm [E pakuptueshme] -- vetëm ndëgjue, e
22 jo pa me sy. Po folim për kohën që është [E padëgjueshme].

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kuptoj. E kuptoj. Do të bëj
24 pyetjen. Unë thjesht doja të dija, "a të kujtohet", dhe ju
25 thatë që po. Prisni që t'ju bëj pyetjen e dytë. Dhe pyetja e

1 dytë është kjo: Ku dhe kur ka ndodhur kjo? Domethënë, kur dhe
2 kur e keni dëgjuar që persona rrëmbeheshin dhe çoheshin në
3 Jabllanicë?

4 PË. Në takimin që a kon mbajt në me këta personat, megjithëse
5 s'e kam këtë versionin shqip, në fshatin Pozharë, prej atij
6 momentit. Nuk e di datën, mirëpo në fillimin e luftës.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush, kush të ka thënë që ka
8 pas një shtab lokal në Jabllanicë? Nga e ke dëgjuar këtë?

9 PË. Po ishte vetë prezent Lahi Brahimaj në q'atë takim, edhe
10 ishin, na kishim marrë vetëm vendim që secili fshat ta ketë
11 strukturat e veta, shtabet lokale.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që ta sqaroj, a kam të
13 drejtë unë të them që ajo ke dëgjuar përpara takimit, pra, që
14 disa persona rrëmbeheshin dhe çoheshin në Jabllanicë, ishin --
15 rrëmbeheshin prej UÇK-së dhe jo prej grupeve të tjera të
16 armatosura, këtë keni dëgjuar, ishte UÇK-ja që i rrëmbente?

17 PË. Për këte nuk e di, sepse UÇK-ja ishte akoma në zhvillim e
18 sipër.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do t'ju pyes edhe në herë.
20 Çfarë keni dëgjuar? Thatë që keni dëgjuar fjalë përpara
21 takimit se po rrëmbeheshin persona. Unë po them, sipas fjalëve
22 që ke dëgjuar, këta persona i rrëmbente UÇK-ja ndonjë grup
23 tjetër i armatosur, policia serbe, forcat serbe, kush?

24 PË. Këto ma tepër asokohe kanë qenë që jam dëgjue
25 thashetheme, kështu që një send që nuk e kam pa me sy, nuk

1 mundem me e vërtetu.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këtë e kuptoj unë. Po çfarë
3 ishin thashethemet? Pra, sipas këtyre thashethemeve, këta
4 personat po i rrëmbente UÇK-ja, forcat serbe, ndonjë grup
5 tjetër i armatosur? Çfarë ke dëgjuar?

6 PË. Aty ma tepër -- ma tepër aty në fillim ma tepër i kemi
7 mendue në atë kohë rrëmbimet i bojshin forcat edhe serbe
8 policore që ishin në terren, por unë po të thom, edhe kam
9 deklaruar edhe përpara që në lidhje me këtë, këto krejt më kanë
10 thonë që ka thashetheme. Prandaj nuk jam dhe nuk di une këto
11 të sqaroj mbase nuk e kam pa me sy ma tutje.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

13 Shohim paragrafin 10 të Shënimit Përgatitor 1. Në këtë
14 paragraf, të paktën sipas këtij paragrafi, i keni thënë
15 Prokurorisë se personalisht ke parë një listë me emra të disa
16 personave, dhe sipas asaj që keni thënë ju, këta persona ishin
17 ende aktiv në LDK dhe Partinë Demokratike Kristiane dhe ishin
18 për pluralizëm politik. Dhe ju keni thënë se këto lista
19 vendoseshin tek shtyllat e dritave në fshatrat ku po fillonte
20 organizimin e vet UÇK-ja. Gjithashtu, sipas paragrafit 10, ju
21 keni thënë se lista ose këto lista nuk thonin kush ishte
22 burimi por që ti e dije që këto lista vinin prej Faton
23 Mehmetaj. E keni thënë këtë Prokurorisë gjatë seancë
24 përgatitore?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani do të doja të më thonit
2 nga e dini ju që këto lista ose i përgatiste ose buronin prej
3 Faton Mehmetaj, thjesht për faktin që kishte makinë shtypi,
4 siç thatë dje?

5 PË. Thjesht që i kishim disa takime në vetë shtëpinë e tijna
6 dhe ai u merrke me këto shkrime me gjithë ato makinat e
7 shkrimit që i kishte në shtëpinë e tij të vendosura. Këtë e
8 kom fol të përgjithshme.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Po ke ndonjë
10 arsye tjetër për të besuar se këto lista vinin prej z.
11 Mehmetaj? E lëmë mënjanë faktin që kishte makinë shtypi dhe
12 shtypte dokumenta në shtëpinë e tij.

13 PË. Po se tërë kohën gjatë qëndrimit tim çdo dokument që u
14 shkrujke, u shkrujke në shtëpinë e tijna.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Shohim
16 paragrafin 11. Është pak më poshtë.

17 Këtë paragraf, ose të paktën sipas këtij paragrafi, i ke
18 thënë Prokurorisë se dëshmitarë të TPNJ-së të Prokurorisë i
19 thërrisnin tradhtarë, spiunë, dhe se "personat që kishin
20 përfunduar akademinë ushtarake gjithmonë kanë pasur probleme
21 me Shtabin e Përgjithshëm gjatë luftës".

22 A të kujtohet që ja ke thënë këtë Prokurorisë që
23 gjithmonë këta kanë pasur probleme me Shtabin e Përgjithshëm
24 nëse e kishin -- pra ata që e kishin përfunduar akademinë
25 ushtarake, kështu?

1 PË. Këtë e kam thënë, por e kam thënë pas takimit dhe pas
2 këtyre ngjarjeve, prej Jabllanicës kur e kemi ditë që është
3 formu Shtabi i Përgjithshëm, dhe pas atyne peripecive dhe
4 divergjencave në mes të FARK-ut dhe Ushtrisë Çlirimtare të
5 Kosovës. A faktikisht FARK-u dhe Ushtria Çlirimtare një qëllim
6 e kemi pas. Jemi kon krejt të bashkuar, s'ka pas kurrfarë
7 problemi derisa na ka ardh Shtabi i Përgjithshëm dhe na ka --
8 na kanë nxjerrë shumë punë. Kjo ishte pyetja ime.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani do të doja të më thoje
10 sipas jush pse këta personat që kishin përfunduar akademinë
11 ushtarake i kishin këto problemet me Shtabin e Përgjithshëm ku
12 ishte zanafilla e problemit? Çfarë problemi kishte?

13 PË. Sipas meje ishte që -- ishte në pyetje karriera e vendit
14 pa u çliru. Ishte në pyetje pozita, kurrgjë tjetër s'kishte të
15 bëjë, ose ma vonë e murrme vesh, sipas meje është fjala,
16 murrëm vesh që po përgatiten forcat e armatosura nga Shqipëria
17 që me hi mbrenda edhe të gjithë ishin oficerë të përgatitur me
18 struktura, me njësi ushtarake krejt, dhe aty për -- për aty,
19 për q'ta ka lind ai problem, ça kam mendu une.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

21 Shkojmë në faqen tjetër, paragrafi 12.

22 Dëshmitar, sipas paragrafit 12 të Shënimit Përgatitor 1,
23 ju i keni thënë Prokurorisë gjatë seancës përgatitore se nuk
24 keni qenë i sigurt, po ama 90 për qind i bindur, se Rexhep
25 Selimi po ashtu ka qenë i pranishëm në takimin e Zhebelit. Të

1 kujtohet që ja ke thënë Prokurorisë që "jam 90 për qind i
2 bindur por jo 100 për qind"?

3 PË. është e vërtetë. Nuk jam akoma i sigurtë se ka qenë
4 prezent Rexhepi, sepse ishte uniforma që e ndryshojke edhe
5 asokohore kur kam -- jam deklaruar kështu, mirëpo, mundet që
6 edhe me qenë me pas qenë prezent. Po jam në dilemë që nuk e
7 kam pa, nuk mundna me e vërtetu që ka qenë saktësisht Rexhep
8 Selimi në atë takim.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sapo thatë se nuk ishit i
10 sigurt se ishte uniforma ndryshe. A mund të na e shpjegosh?
11 Unë e kisha këtë 10 për qindëshin që je i pasigurt, pse ke
12 thënë jam vetëm 90 për qind i sigurtë dhe jo 100 për qind.

13 PË. Se uniformën të gjithë e kishin të njëjtë të Ushtrisë
14 Çlirimtare të Kosovës e njeriu me uniformë ndryshon. Kështu që
15 nuk kishim takime të shpeshta që me e njoft personalisht
16 njërin. Ajo ishte bindja ime. Personalisht nuk kishim takime
17 të përparshme të shpeshta që me e njoft personin.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Shkojmë në
19 paragrafin 15.

20 Dëshmitar, në këtë paragraf, keni folur për takimin --
21 për faktin që keni takuar tri herë z. Hashim Thaçi gjatë
22 luftës, e keni diskutuar dhe dje këtë si me Prokurorinë dhe me
23 Mbrojtjen e z. Thaçi. Dhe sipas këtij paragrafi keni pasur
24 takim me z. Thaçi dhe z. Zyrapin në zyrën tuaj, në kazermën e
25 Prapaqanit, dhe gjatë këtij takimi z. Thaçi, sipas asaj që i

1 keni thënë ju Prokurorisë ka qenë me tesha civile, ndërsa z.
2 Zyrapi ka qenë me uniformë të UÇK-së. I qëndroni ende kësaj?
3 PË. E vërtetë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Mesa ju
5 kujtohet ju, z. Thaçi kishte armë me vete, mbante armë?
6 PË. Kur ka qenë civil, nuk ka pa. Vetëm që mbështetjen e
7 tijna e ka pas me uniformë. Bislum Zyrapi ka qenë me të. Nën
8 setër nuk di çka ka pas, por, jo. Shumë thjesht, shumë human,
9 shumë pedant mos them, ishte dhe ajo, ta përshkruaj ashtu. Sa
10 më kujtohet mue.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] I kishin shoqëruar --
12 shoqëronin me ushtarë ata? Kishte ushtarë të tjerë me ta?

13 PË. Aty kishte ushtarë të tjerë mirëpo ato ushtarë ishin të
14 kazermës së Prapaqanit kështu që përpos Bislum Zyrapit nuk kam
15 mujt me dallu dikush tjetër që ka qenë ushtar me te.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sipas shënimit përgatitor
17 keni thënë që në atë kohë nuk e dinit se çfarë posti kishte z.
18 Thaçi dhe se nuk e kishit asnjëherë -- nuk kishit dëgjuar
19 asnjëherë për të më përpara, saktë?

20 PË. E vërtetë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po z. Zyrapi e dinit kush
22 ishte?

23 PË. E disha që është oficer, koleg i angazhuar në luftë sikur
24 une, po çfarë posti mbajke, nuk e di. Edhe pse kam pas
25 kontakte me te, por kurrë nuk e kam pyet, as nuk më ka tregue.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në atë kohë e dinit ju nëse
2 z. Thaçi apo z. Zyrapit ishin anëtarë të Shtabit të
3 Përgjithshëm, e dinit këtë gjë në atë kohë?

4 PË. Jo.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po tani, për shembull, e
6 dini që z. Thaçi ka pasur një nofkë, një pseudonim gjatë
7 luftës?

8 PË. Tani e di, mbas lufte. Gjatë luftës, po e di.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Cila ka qenë?

10 PË. Gjarpri.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Thatë sipas transkriptit
12 gjatë luftës, po, e dinit? Domethënë, e keni ditur dhe gjatë
13 luftës që e ka pasur këtë pseudonim?

14 PË. Gjatë luftës sa kam qenë, jo, por në tërheqje e sipër
15 masanej nëpërmes mjeteve të informimit edhe mes zërave të
16 ndryshëm kam dëgjue që pseudonimi i tij ka qenë Gjarpri. Edhe
17 në disa libra të tjera që kanë shkruar pas luftës me pseudonimin
18 Gjarpri.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, fjalia e fundit
20 në paragrafin 15, thotë që:

21 "Folëm për luftën."

22 Dhe ma merr mendja këtu e keni fjalën për z. Thaçi dhe z.
23 Zyrapit kur thoni "ata", kështu?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për çfarë folën, për

1 shembull, folën për luftën në vija të përgjithshme, a kishte
2 ndonjë aspekt kontrekt, për shembull, si ishte situata në
3 territorin tuaj të përgjegjësisë, për çfarë? Cila isha tema
4 kryesore e kësaj bisede?

5 PË. Të gjitha këto nuk muj i di. Mirëpo, ka pas takime se në
6 atë kohë vetëm për organizim, organizimin e luftës kemi fol
7 edhe për ma tepër ka qenë tema që LDK-ja, Ibrahim Rugova, edhe
8 ato tema kanë qenë, por konkretisht nuk më kujtohet. Kështu që
9 ka qenë një bisedë shumë e drejtë, pa tensione me te vetëm ma
10 shumë ka fol Thaçi sesa na. E ma tutje nuk e di, s'më kujtohet
11 diçka ma shumë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Herën e dytë
13 dhe të tretë që e ke parë z. Thaçi gjatë luftës, çfarë po vish
14 -- çfarë kishte veshur ai të kujtohet?

15 PË. Herën e dy, po. Herën e tretë e kam pa në fshatin
16 Bardhaniq e ka qenë i armatosur dhe me uniformë.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 15, në faqen
18 5, thuhet që e ke parë prapë z. Thaçi në kazermën e Prapaqanit
19 bashkë me z. Selimi. Ma merr mendja këtu kur ke thënë Selimi e
20 ke pas fjalën për Rexhep Selimin?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në atë kohë, po në ato
23 momente, z. Thaçi ishte me tesha civile apo me uniformë
24 ushtarake?

25 PË. Nuk jam i sigurt se aty ka pas shumë ushtarë, kështu që

1 në mesin e ushtarëve i rrethum nuk më kujtohet. Nuk -- nuk
2 mujna me e dit.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] S'ka problem. Po z. Selimi,
4 a të kujtohet çfarë kishte veshur ai, uniformë, apo civil?
5 PË. Uniformë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani do të doja të shihnim
7 paragrafin 18 të Shënimit Përgatitor 1. Kjo lidhet me
8 deklaratën që i keni dhënë ish-Tribunalit të Hagës në 2002-
9 shin. Është numri i provës P01593, për Gjykatën tonë.

10 Në paragrafin 18 flitet për një takim që është mbajtur në
11 Jabllanicë, dhe sipas shënimit keni thënë se vendimi për të
12 mbajtur takime në Jabllanicë u mor nga z. Ramush Haradinaj dhe
13 Sali Veseli, sepse donin që shtabi të ishte më i madh dhe të
14 emëronte komandantin. Keni thënë se dhe Rexhep Selimi ka qenë
15 i pranishëm në takimin e Jabllanicës, por që asokohe nuk e
16 dije se çfarë posti kishte ai. Është ende kjo dëshmia juaj?
17 PË. E vërtetë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në deklaratën që i keni
19 dhënë TPNJ-së P01593, faqja 11, keni thënë se z. Rexhep Selimi
20 nuk u -- nuk është prezantuar si anëtar i Shtabit të
21 Përgjithshëm të UÇK-së gjatë mbledhjeve, kështu?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ju gjithashtu keni thënë
24 se jeni njoftu për herë të parë me të në Jabllanicë, mbledhje
25 në Jabllanicë?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Por më vonë keni mësu se
3 ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Kështu keni
4 thënë në deklaratën që i keni thënë TPNJ-së, pra i Shtabit të
5 Përgjithshëm të UÇK-së. Është -- pra, e mësuat më vonë, morët
6 vesh më vonë që ishte anëtar.

7 PË. Po, për të gjithë këta, kam dëgjue pas mbledhjes të në
8 fshatin Zhebel, kur dulën populli, që dul, dulën dhe emrat. Po
9 këtu mund ta shtoj që në Jabllanicë Rexhep Selimi ka qenë me
10 teshat civile, jo me uniformë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe dua të
12 sigurohem që ju kam kuptuar drejt kur thoni se e keni dëgjuar
13 nga publikimet në media që z. Selimi ishte anëtar i Shtabit të
14 Përgjithshëm të UÇK-së. Pas mbledhjes në Jabllanicë, e morët
15 vesh?

16 PË. Po, nëpërmes mbledhjeve, nëpërmes mbledhje, tash s'më
17 kujtohet saktësisht edhe mjeteve të informimit asokohe.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe po kështu e morët vesh
19 se cili ishte posti apo funksioni i z. Selimi në një moment,
20 pra nëse kishte të tilla në '98-n?

21 PË. Jo, s'e di.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po tani e dini se çfarë
23 funksioni e ka pas atëherë?

24 PË. Sipas, apat informimeve, e gjitha ka qenë anëtar i
25 Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kaq dëgjuat? Asgjë më shumë?

2 PË. Kaq. Kaq.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, se çfarë bënte në

4 Shtabin e Përgjithshëm ju edhe tani nuk e dini?

5 PË. Nuk e di.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kalojmë tani

7 në paragrafin 25 të Shënimit Përgatitor nr. 1.

8 Dëshmitar, sipas këtij paragrafi, Prokurorisë i keni
9 thënë se Faton Mehmetaj ju ka thënë vetë gojarisht, ju ka
10 tregu për një listë të zezë, ku përfshihej dhe emri i një
11 individi të cilin ju e njihnit asokohe. Dhe z. Mehmetaj ju ka
12 tregu se ky individ ishte një person i kërkuar dhe i
13 padëshiruar dhe ju keni kujtuar se ky person kërkohet ngaqë
14 ishte bashkëpunëtor i Adem Jashari që ishte afër me LDK-në dhe
15 se ishte dhe themeluesi i FARK-ut. Ju kujtohet që e keni thënë
16 këtë, UÇK-së - më falni - Prokurorisë?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mund të na thoni, ju lutem,
19 se ku dhe kur z. Faton Mehmetaj ju ka treguar për këtë listë
20 të zezë dhe se ky person ishte i padëshiruar apo që kërkohet,
21 ishte person në kërkim, si me thënë?

22 PË. Faton Mehmetaj ishte nën zonën numër 3 që isha unë
23 komandant. Ma vonë mu afrue sepse i kishim ndryshe raportet,
24 ma të afërta. Dhe sa më kujtohet ky rast ka qenë në fshatin
25 Prapaqan, por jo në zonën e garnizonit, por ishte në një vend

1 krejt tjetër në fshatin Prapaqen. Krejt ç'ka di është q'kjo,
2 në lidhje me këtë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, z. Mehmetaj, jua ka
4 treguar këtë kur keni qenë në fshatin Prapaqen, kështu?
5 PË. Po, në fshatin Prapaqen.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po koha kur jua ka treguar
7 këtë gjë?

8 PË. Nuk e di.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

10 Kam tani një pyetje lidhur me paragrafin 28 të dok -- të
11 Shënimit Përgatitor nr. 1. Z. Sekretar i Gjykatës të shkojmë
12 në atë paragraf.

13 Sipas këtij paragrafi, ju keni folur për një person që ka
14 qenë gazetar, raportonte për luftën gjatë luftës, dhe
15 gjithmonë ka qenë mbështetës i LDK-së. Prokurorisë sipas këtij
16 dokumenti i keni thënë se e keni parë emrin e këtij personi në
17 një fletore, në një bllok shënimesh të z. Togeri.

18 Për procesverbal, a mund të na thoni se kush ishte zoti,
19 ky -- cili ishte emri i Togerit?

20 PË. Emrin e Togerit e kam mësu pas luftës. Unë për gjatë
21 luftës fare s'e kam dit si e ka emrin. Mbas lufte e kam dëgju
22 që ai ka qenë Idriz Bala.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. I keni thënë
24 Prokurorisë se Idriz Bala, apo Togeri, ju ka thënë se emri i
25 këtij personi, emri i këtij gazetari ishte në atë bllok, ishte

1 ngaqë ishte anëtar i LDK-së dhe që raportonte si gazetar për
2 LDK-në dhe FARK-un, kështu?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Prapë pyetja është e njëjtë,
5 ku dhe kur jua ka treguar Togeri këtë gjë?

6 PË. Kur nuk e di, koha kur kemi qenë ma të lirë në zonën e
7 luftës. Nuk e di në cilën kohë, në cilën datë, nuk mundem me
8 majt mend.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Duke përdorur deklaratën e
10 vitit 2002 që i keni dhënë TPNJ-së me numër P1593, në faqen
11 19, aty thuhet se ju i keni thënë, i keni treguar TPNJ-së apo
12 z. Togeri apo Idriz Balaj jua ka thënë këtë gjë në fshatin
13 Irzniq në fund të majit 1999 -- 1998, më falni. Më falni, në
14 fund të majit të '98-s jua ka treguar këtë gjë, me sa ju
15 kujtohet?

16 PË. Atëhere me siguri e kam kujtesën ma të mirë, sot nuk më
17 kujtohet, por e di që më thatë që në fshatin Irzniq ka qenë,
18 edhe m'u kujtu.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetje.
20 Pyetjet e fundit kanë të bëjnë me Shënimin Përgatitor nr. 2.

21 Kërkoj që ta nxjerrim në ekran z. Sekretar. Paragrafi 18,
22 ju lutem.

23 Dëshmitar, sipas paragrafit 18, këtu thuhet që Prokuroria
24 ju ka treguar një provë materiale me numër P00486 dhe ju i
25 keni treguar Prokurorisë se keni dëgjuar se z. Thaçi tha si

1 vijim, dhe ka të bëjë me atë telefonatën me telefon satelitor
2 midis z. Thaçi dhe z. Ahmet Krasniqi se:

3 "Do ta kry misionin me ty shumë shpejt, punën ose
4 misionin me ty shumë shpejt".

5 Por ju gjithashtu thoni se nuk e di se kujt ja tha këto
6 fjalë, a ja tha z. Krasniqi në telefon, a ja tha z. Zemaj, i
7 cili ishte aty i pranishëm me z. Thaçi, a ua tha të dyve? Ju
8 kujtohet që e keni thënë këtë? që keni folur për këtë me
9 Prokurorinë?

10 PË. Po, më kujtohet.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dje na thatë, është në faqen
12 e transkriptit 19458, që z. Thaçi pretendohet se i ka thënë
13 një personi që ju nuk e dini se kush ishte, z. Krasniqi, a z.
14 Zemaj a dikujt tjetër që "Do ta kryjm, do krymë shpejt me ty".

15 Dëshiroj të di tani se çfarë ka thënë saktësisht z.
16 Thaçi, a ka thënë a do ta kryjm këtë mision, këtë punë me ty
17 shumë shpejt, apo mbarojmë punë me ty shumë shpejt?

18 PË. Shumë shpjet do ta kryjm edhe këtë punë edhe me ty. Po
19 nuk e di a i ka thonë Tahir Zemës, a e ka pas me Ahmet
20 Krasniqin. Edhe e gjitha kjo ka qenë në tension. U dëgjojshin
21 zërat në tension mes Tahirit dhe Hashimit.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Tani, sipas jush,
23 këto fjalë të atij, çfarë ka dasht me thonë me ato fjalë? si i
24 kuptoni?

25 PË. Unë e kuptoj që ka qenë në [E pakuptueshme] njeri moment

1 në atë kohë ose ka qenë bukur vështirë me i thon ato fjalë kur
2 ishim të gjithë të armatosur. Edhe Tahiri ka qenë i armatosur,
3 edhe Hashimi, edhe e kishim një ushtri aty. Kështu që nëse e
4 lyp mendimin tim, ma merr mendja që çdogja i pështue në nervoz
5 në krejt.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo, ajo që po më intereson
7 të di është që këto fjalë, si mendoni, ishin një kërcënim, apo
8 ishte një këshillë? Si i kuptoni ju këto fjalë që janë thënë
9 aty?

10 PË. Ma shumë kërcënim.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani dëshiroj të kalojmë në
12 paragrafin 19 të Shënimit Përgatitor nr. 2.

13 Në këtë paragraf thuhet se i keni thënë Prokurorisë se z.
14 Thaçi ka folur me ju për fotografinë e z. Rugova, President
15 Rugovës, që ishte një fotografi e varur në mur në zyrën tuaj,
16 edhe ka fol edhe për LDK-në. Ma merr mendja se bëhet fjalë për
17 takimin që keni zhvilluar me z. Zyrapi dhe z. Thaçi në zyrën
18 tuaj në Prapaqan, apo jo?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju lutem, Na tregoni se
21 çfarë ka thënë saktësisht z. Thaçi, çfarë tha për LDK-në dhe
22 çfarë tha për fotografinë e z. Rugova?

23 PË. Unë e thashë edhe dje, edhe po [E pakuptueshme] që nuk më
24 kujtohet prej djeshit çfarë thashë, por ka qenë tema dhe edhe
25 fjala për fotografinë e Ibrahim Rugovës me e hjek prej murit.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Thatë diçka tjetër për
2 fotografinë apo LDK-në?
3 PË. Edhe në lidhje me forcat e FARK-ut që janë anëtarët --
4 shiqo, q' tu është kon gabimi më i madh që e kanë kuptue që
5 forcat e FARK-ut, Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës
6 ka qenë të gjithë LDK, kjo nuk ishte e vërtetë. Ka pas të
7 gjitha partive të tjera vullnetarë, ushtarë, por në vëmendje
8 ka qenë që nëse janë Forcat e Armatosura, janë të LDK-së. Aq
9 mujna me [E pakuptueshme].

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar. Kaq
11 pyetje kisha.

12 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
13 Mettraux, keni fjalën.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
15 Smith.

16 Mirëdita, z. Dëshmitar.

17 Dua të filloj me disa pyetje.

18 PË. Mirëdita.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua të filloj me disa
20 pyetje lidhur me Faton Mehmetajn.

21 Dje bëtë -- na bëtë me dije se ju e dinit se Faton
22 Mehmetaj vepronte mes të tjerash si përfaqësues politik në
23 zonën e Dukagjinit, por jeni i sigurt se ne emër të kujt ka
24 vepruar ai. E kam kuptuar qartë këtë?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretarit të
2 nxjerrë në ekran provën materiale 1D50.

3 Zotëri, ju kujtohet që jua kanë treguan dje këtë
4 dokument? Jua tregoi Avokati Mbrojtës i z. Thaçi?
5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në pamje të parë duket se
7 është një Deklaratë Politike nr. 7, e datës 13 gusht 1999, dhe
8 thuhet se ka dalë nga Drejtoria Politike e Ushtrisë Çlirimtare
9 të Kosovës, Shtabi i Përgjithshëm në atë datë.

10 Ju lutem të shihni të njëjtin paragraf të cilin jua
11 lexuan dje. Paragrafi i tretë i plotë që fillon me fjalën --
12 me fjalët "Rrethanat e reja...". E gjetët? "Rrethanat e
13 reja...".

14 PË. Jo, [E pakuptueshme], duhet me e lexu pak ma...

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Është paragrafi në shqip,
16 nëse doni të përdorni versionin shqip, ku përmendet emri Sokol
17 Bashota, e shihni?

18 PË. Bashota, po, po.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në anglisht thotë kështu:

20 "Rrethanat e reja imponojnë krijimin e institucioneve në
21 të cilat spektri i gjerë politik i Kosovës do të përfaqësohet
22 me qëllim të ndërprerjes së manipulimeve lidhur me krijimin e
23 këtyre institucioneve. Shtabi i Përgjithshëm bën publik faktin
24 se Jakup Krasniqi, Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti, Hashim
25 Thaçi, Faton Mehmetaj dhe Sokol Bashota janë përfaqësuesit

1 politikë të UÇK-së. Dalja publike e përfaqësuesve politikë të
2 UÇK-së lehtëson bashkërendimin e veprimtarisë politike në
3 rrafsh kombëtar.”

4 E shihni këtë?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, të paktën sipas këtij
7 dokumenti, Faton Mehmetaj ishte bërë anëtar i Drejtorisë
8 Politike të UÇK-së, Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, jo më
9 vonë sesa 13 gushti 1998. E shihni?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe më duket se më përpara
12 thashë “1999”. Po e kisha fjalën për 1998.

13 Tani, gjatë luftës, ju a keni qenë në dijeni të
14 ekzistencës së drejtorisë politike, të kësaj drejtorie
15 politike dhe se cilat ishin funksionet e asaj drejtorie
16 politike?

17 PË. Jo.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk po ju kritikoj, po kjo
19 mbase ka ndodhur për shkak të faktit se ju nuk keni qenë në
20 dijeni të mënyrës sesi funksiononte brendapërbrenda Shtabi i
21 Përgjithshëm? Do të ishte e saktë nëse do të thosha kështu?

22 PË. Mund të jetë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretarit të
24 nxjerrë në ekran një dokument me numër ERN-je 056484. Ka të
25 njëjtin numër dhe në shqip.

1 Në anglisht faqja tjetër. Me të njëjtin numër ERN në
2 shqip 056484. Faleminderit.

3 Do t'ju jap një çast që të arrini ta lexoni dokumentin.

4 Ju lutem pjesën e poshtme të dokumentit ta shikojë
5 dëshmitari në ekran.

6 Pyetja e parë që kam zotëri është kjo: A jeni në dijeni
7 apo a e kishit parë më përpara këtë dokument?

8 PË. Për herë të parë po e shoh. Edhe Shtabi i Përgjithshëm
9 nënshkrimi, veç nënshkrimi këtu nuk po -- nuk po shkrun emri i
10 personit, Shtabi i Përgjithshëm.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ta shihni nga
12 përmbajtja pretendon që të jetë një vendim i datës 1 shtator i
13 viti 1998, ka dhe një numër protokolli 535/611, thuhet se vjen
14 nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
15 Pretendon të jetë një vendim i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-
16 së për emërimin e Faton Mehmetajt në postin e
17 ndihmëkomandantit për informim publik në shtabin e nënzonës
18 operative të Dukagjinit, ku thuhet se ky vendim hyn në fuqi
19 menjëherë dhe në versionin në anglisht thuhet se e ka bo
20 Rexhep Selimi.

21 PË. Rexhep Selimi, a në versionin shqip tash po e shoh, po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja e parë që kam është
23 kjo, nëse e dinit apo jo nëse Faton Mehmetaj në verë të 1998-s
24 më saktë më 1 shtator 1998 është emëruar si ndihmëskomandant
25 për informim publik pranë shtabit të nënzonës operative të

1 Dukagjinit me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, të paktën siç
2 na e tregon ky vendim. Ju a ishiti në dijeni për këtë gjë?

3 PË. Jo. Për herë të parë po e shoh.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe siç e keni kuptuar ju
5 rolin apo rolet e Faton Mehmetaj, ju thatë që ka luajt disa
6 role, ky urdhër a përputhet me atë siç e keni pa ju, siç e
7 keni kuptu ju që ka vepruar ai gjatë vitit 1998, verës së
8 vitit 1998?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtu përmendet nënzona
11 operative e Duagjinit. A e kuptoj drejtë unë që kjo fjala
12 "nënzona" është përdorur deri në fund të tetorit të vitit 1998
13 kur nomenklatura, më saktë terminologjia ka ndryshuar, pra nuk
14 quhej më nënzona, po filloi të quhej "zona". Për këtë jeni në
15 dijeni?

16 PË. Qysh përpara me formimin e shtabit të Rrafshit të
17 Dukagjinit, ne nuk kemi qenë nënzona, po kemi qenë zona. Dhe
18 në kuadër që kam fol edhe përpara, në kuadër të zonës i kemi
19 nda nënzonat, numër 1, 2, 3, nëse ju kujtohet që e kam --

20 Sikur herët jemi da në nënzona atëhere pse m'u qujt në
21 shtator a kur ke kjo datë -- po, në shtator, me u qujt
22 nënzona, nënzona e shtabit operativ të Rrafshit të Dukagjinit.
23 Kjo është një dokument që të jep me kuptu veç "Hajt që po
24 mundna me shkru edhe po e jap një nënshkrim edhe po e bëj
25 dikënd le të gjindet".

1 Se s'ka kjo të bëjë, për mu s'ka kurrfarë vlere. Ma
2 saktë, a din.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po pse e thoni kështu, pse
4 e thoni këtë, zotëri?

5 PË. E thonë që ju kujtohet kur kam fol për Faton Mehmetin që
6 nëpërmes radios e kemi dëgjue që Faton Mehmeti është bo
7 përfaqësues politik u Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në
8 Rrafshin e Dukagjinit. Që kurrkush nuk e ka dit edhe më
9 kujtohet fort mirë që edhe me Tahirin po edhe me Ramushin,
10 bile Tahiri na ka boe, tash po e lidh, të dyve në pyetje,
11 "Kush e ka zgjedhë?". Ramush Haradinaj o deklaruar se "hiç s'e
12 di". Edhe kam pas probleme në fshatin e tijna ushtarë të tjerë
13 që momentin kur e kanë zgjedhë përfaqësues e ka njoft ma mirë
14 se këta, që e kanë njoft prej shtabit, e kemi dit kush është,
15 çfarë elementi është ai, në atë aspekt, që kurrkush s'e ka
16 dashtë. Ai ka qenë një njeri i izoluar vetëm që ka pas një
17 uniformë me pushkë. E me kon a lidh, qysh o lidh, në cilën
18 rrethana ka depërtu, ai veç vetë e din edhe e din Shtabi i
19 Përgjithshëm [E pakuptueshme].

20 Po kjo është edhe një dokument që po e vërteton q'ata që
21 kam fol. Herë i informimit, herë i zbulimit, herë anej, herë
22 knej, tani përfaqësues politik, tashti ndihmëskomandant i
23 nënzonës. Cila nënzonë?

24 Atëherë kena kon ndihmëskomandnat i nënzonës një që e
25 kemi qujt na, kur i kemi da nënzonat, komandant ka qenë Ramush

1 Haradinaj. Në nënzonën 3 kam qenë unë.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.

3 Kam disa pyetje të tjera por mbas pushimit.

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani ka ardhur
5 koha për të bërë pushimin prej gjysëm ore, Dëshmitar. Ju lutem
6 do të dilni nga salla bashkë me Asistenten e sallës. Mos
7 harroni të mos flisni me askënd lidhur me dëshminë tuaj këtu
8 në sallë.

9 Bëjmë këtu ndërprerjen e seancë deri në orën 11.30.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 --- Pauza fillon në rone 11.04

12 --- Seanca rifillon në orën 11.30

13 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
14 dëshmitarin në sallë, ju lutem.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tetaj, do
17 vazhdojmë me pyetjet e Trupit Gjykses. Ka ende pyetje Gjykatës
18 Mettraux.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjes sërish, z.

20 Tetaj.

21 I lutem Sekretarisë të nxjerrë në ekran provën P270.12.

22 Do t'ju jap -- po të jap një çast të njiheni me tekstin,
23 por në pamje të parë duket se është një komunikatë, Komunikata
24 nr. 62 e Shtabi i Përgjithshëm të UÇK-së. Nuk ka datë këtu,
25 por është e botuar te Koha Ditore më 15 nëntor 1998. Edhe unë

1 dua që të shohim një paragraf. E lexon dot shqipen? Arrin?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju jap një çast që të
4 njiheni me përmbajtjen, kryesisht këtu flitet për
5 ristrukturimin e UÇK-së që po ndodhte në nëntor 1998. Lexojeni
6 një herë dhe pastaj bëjmë pyetje.

7 PË. Krejt me e lexu?

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, do të them unë çfarë
9 paragrafi na duhet. Por pyetja ime e parë është kjo: A ju
10 kujtohet ta keni parë këtë komunikatë në kohën kur ka dalë nga
11 nëntori 1998? Të kujtohet ta kesh parë në atë kohë?

12 PË. Jo. Për herë të parë jam tu e pa.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në fund të faqes
14 tek anglishtja. Faleminderit.

15 Dhe ne na intereson kjo që thotë "Institucionet e cekura
16 më lartë...".

17 E gjen dot në shqip paragrafin? Duhet të jetë diku nga
18 fundi i artikullit aty ku është emri Faton Mehmetaj dhe i Ramë
19 Bujës. Është paragrafi që ka këto dy emrat të përmendur.

20 PË. Po, aty e ka, po e shoh.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në anglisht, dokumenti,
22 pra Komunikata 62 thotë si në vijim, është paragrafi i fundit,
23 fjalia e tretë:

24 "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së thuhet se ka përfunduar --
25 përmbyllur ristrukturimin e organizimin e brendshëm si dhe ka

1 bërë ushtri në drejtorinë politike duke hequr ... Faton

2 Mehmetajn dhe emërimin e ... Ramë Bujës.”

3 Më pas shton:

4 “Shtabi i Përgjithshëm UÇK-së shpreh shqetësimet e tij
5 dhe distancohet nga aktet e kidnapimeve edhe pa rëndësi se
6 kush janë personat apo etnitë e përfshira në këto rrëmbime.”

7 Pyetje ime e parë është kjo: A e keni ditur ju që nga
8 mesi i gushtit 1998 deri përafërsisht në mes të nëntorit 1998
9 Faton Mehmetaj ka qenë anëtar i Ushtrisë Çlirim -- pra, i
10 drejtorisë politike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së? A e
11 keni ditur ju këtë?

12 PË. Jo.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e keni ditur ju se gjatë
14 kësaj periudhe, ose për të paktën një pjesë të kësaj periudhe,
15 z. Mehmetaj, ka vepruar si pranë Shtabit të Përgjithshëm, më
16 konkretisht në drejtorinë politike, dhe në zonën tuaj? Pra, e
17 keni ditur që njëherazi ka mbajtur dy funksione?

18 PË. Në zonën tonë sa ka qenë e di, sa i përket shtabit dhe
19 drejtorisë politike të Shtabit të Përgjithshëm nuk e di.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk po ju kritikoj, të më
21 mirëkuptoni, por kjo për arsye se nuk keni qenë i informuar
22 tërësisht ju mbi natyrën dhe shkallën e përfshirjes së Shtabit
23 të Përgjithshëm në zonën tuaj? Do të ishte ky një përshkrim i
24 konstatimit të drejtë.

25 PË. Shumë i saktë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të pyes për dokument
2 tjetër. Është prova P600 -- 1600, më falni. Këtë dokument e
3 keni parë edhe më përpara, po kam dy pika që dua të trajtoj.

4 Besoj të kujtohet që mendohet se është një procesverbal i
5 një takimi në shtabin e -- operativ, më falni, në shtabin
6 operativ të Rrafshit të Dukagjinit, data është 25 korrik 1998.
7 Të lutem, shih fillimisht listën e personave që kanë qenë të
8 pranishëm dhe ata që kanë qenë -- që nuk kanë qenë të
9 pranishëm, që kanë munguar, e shihni?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa duket, dhe më
12 korrigjoni, ju lutem, nëse e kam gabim, këtu thuhet se ju nuk
13 keni qenë i pranishëm dhe se keni mbërritur pasi kishte
14 filluar takimi. A të kujtohet që ke shkuar në këtë takim pasi
15 kishte filluar dhe që nuk keni qenë aty që në fillim? Ju
16 kujtohet?

17 PË. Nuk më kujtohet, a për sa i përket takimeve mund të jetë,
18 por për me e dit duhet me e lexu krejt, se në versionin shqip
19 më është e shkruar që shumë dobët. Edhe shumë kisha pas
20 dëshirë me i këqyr të gjitha edhe me dit që me dhënë në
21 përgjigje [E padëgjueshme].

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të pyes për një gjë
23 konkrete. Mesa të mundeni përgjigjuni.

24 Shkojmë më poshtë tek anglishtja, ju lutem, në këtë faqe.

25 Këtu, të paktën tek anglishtja shkruhet se

1 "- Kemi vendosur që Tigri të jetë komandant i
2 policisë..."

3 E sheh në shqip, e gjete në shqip ekuivalentin?

4 PË. Po. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në anglisht thotë:

6 "- Kemi vendosur për Tigrin si komandant të policisë dhe
7 kemi marrë miratimin e Shtabit të Përgjithshëm. Brigadat e
8 përkrahin idenë e policisë ushtarake."

9 Pyetja ime është kjo: A e keni ditur ju që ishte kërkuar
10 miratimi i Shtabit të Përgjithshëm apo ishte marrë miratimi i
11 Shtabit të Përgjithshëm për emërimin e Tigrin si komandant të
12 policisë ushtarake?

13 PË. Këtu është problemi, se na kemi qenë si shtab rajonal i
14 Rrafshit të Dukagjinit. Dhe kur ma përmend Tigrin mu kujtue ky
15 takim. Mirë, këtu është e shkrueme me qëllim shtabi, "miratimi
16 nga Shtabit të Përgjithshëm të Rrafshit të Dukagjinit". Kjo
17 është shkrueme pasi, pas gjatë asaj që unë nuk e kam pa, e tani
18 po e shoh. Na e kemi prur vendimin që, domethënë, na, shtabi
19 operativ i Rrafshit të Dukagjinit e jo shtabi operativ i
20 Shtabit të Përgjithshëm, që e kemi prur vendimin që Tigri me
21 qenë komandant policisë ushtarake në regjionin e Rrafshit të
22 Dukagjinit. E këtu disa herë o bo me qëllime, shkrun herë
23 Rrafshi i Dukagjinit edhe në disa dokumenta të tjera e kam pa,
24 edhe gjatë periudhës që kush s'e ka dit që ekziston [E
25 padëgjueshme].

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa kuptoj unë nga
2 përgjigja juaj, ju nuk e keni ditur që ishte kërkuar ky
3 miratim nga Shtabi i Përgjithshëm -- a ishte kërkuar vërtetë
4 një miratim i tillë?

5 PË. S'e di, dhe s'besoj.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Do t'ju pyes
7 për diçka tjetër që keni diskutuar dhe me Gjykatësin Barthe.
8 Bëhet fjalë për këto listat e zeza që mbanin, që kishin emra
9 personash të cilët kërkoheshin. Të kujtohet që u diskutua kjo
10 gjë?

11 PË. Për momentin, jo, se në qoftë se e kam shkru dikund ose
12 ka qenë asokohe, a kon çështje më e kthjelltë. Për momentin
13 nuk po më kujtohet emrat e atyne personave që kanë qenë në
14 lista.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] T'ju pyes kështu: Ju thatë
16 që keni parë një listë personash që e kishte Faton Mehmetaj. A
17 të kujtohet që u diskutua kjo sot duke dhënë dëshmi?

18 PË. Po, po, po, në qoftë se për këtë, po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe pyetja e ime e parë
20 është kjo: Në zonën tuaj të përgjegjësisë, në territorin tuaj,
21 kush i përdorte këto lista përveç Faton Mehmetajt? Kishte
22 ndonjë person tjetër që i mbante këto lista nëpër duar dhe i
23 përdorte për ndonjë qëllim?

24 PË. Jo, vetëm Fatoni edhe me ju thonë të drejtën Togeri, në
25 qoftë se ka pas lista që po lidhen me këtë pyetje, ai nuk ka

1 qenë e atij regjioni dhe nuk e ka njoft asnjë person. Mirëpo,
2 në koordinim me Faton Mehmetin ka mujt me qenë ndonjë listë
3 edhe në duart e Togherit.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa keni ju dijeni, këto
5 lista a përdreshin në postbllloqet e UÇK-së në zonën tuaj?
6 PË. Në fillim, po. Në fillimin e luftës, po. Edhe më fal, a
7 bën?

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

9 PË. Dhe për shkak të q'tyne listave ne në fillim të luftës na
10 e kemi bo secili fshat e kemi qit rojën që me dit kush po hin
11 në fshat dhe kush po del. Mos me pa qenë qeto lista ne s'kemi
12 pas nevojë nëpër ato fshatrat tona me bo roje.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A i ke shprehur ndonjëherë
14 shqetësimet e tua me Ramush Haradinaj, i ke ndarë ndonjëherë
15 shqetësimet e tua për këto lista dhe pse po përdreshin këto
16 lista?

17 PË. Nuk më kujtohet në te, që kam bisedu ndonjëherë, sepse
18 ishin nënzonat, zona e Rrafshit të Dukagjinit ishte e ndarë.
19 Kështu që une isha në zonën e tretë, ata ishin në zonën numër
20 një. Edhe koha nuk ka arrit që të gjitha këto t'i sqarojmë dhe
21 të takohemi dhe të informojmë për këto që është ma gjerë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në deklaratën tuaj keni
23 përmendur dhe atë rastin ku ju vetë personalisht jeni marrë në
24 pyetje nga Faton Mehmetaj dhe nga Ujku. Të kujtohet?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ujku është Pjetër Shala?

2 PË. Pas luftës edhe kur është arrestu e kam dit emnin e tijna
3 që është Pjetër Shala.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime është kjo:

5 Çfarë pyetjesh ju bëri z. Mehmetaj dhe a ju bëri ndonjë pyetje
6 edhe z. Shala, z. Pjetër Shala?

7 PË. Mu më kanë marrë nga fshati me prapavijë që unë jam
8 oficer ushtarak dhe më kanë çu në xhaminë e Pozharit, dhe të
9 dytë më kanë marrë në pyetje.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po çfarë pyetjesh të bënë,
11 për çfarë të pyesnin?

12 PË. Kam fol edhe përpara, pyetja ishte se pse une -- pas
13 sulmit të Gllogjanit zonat ishin të lira, e ishte Deçani,
14 ishin i lirë, shkojnë në treg njerëzit. Lëvizjet e
15 përgjithshme ishin të lira, edhe kam shkue për shkaqe të mia
16 personale, shëndetësore, që vujsha prej hernia në atë kohë dhe
17 e disha ça po më pret, e dojsha me marrë do barna nga
18 ortopedi. Edhe për hir që isha shkue, ka kish ndëgju ai, nuk e
19 di, edhe tash dojke me njollos gjoja që unë kam shkue për
20 ndonjë shërbim tjetër. Kaq mundna me thonë sa i përket kësaj
21 situatë.

22 Ajo s' ishte e vërtetë ç'ka folke ai, por qëllimi ishte që
23 gjithqysh me më njollos. Ma vonë e mora vesh - edhe këtë po e
24 shtoj - edhe kur isha unë hala akoma në zonën e Rrafshit të
25 Dukagjinit, në Rugovë, në mujin tetor Zëri i Kosovës ka shkru

1 një listë që kam qejf me dit e me më ra, që më kanë thonë të
2 tjerët ç'ka ka shkru ai e çfarë njollosje ka bo për mu edhe
3 për shumë të tjerë të asaj zone. Domethënë, është kon
4 përgatitja. Ai prej Shqiprie e ka bo atë edhe unë kam qenë në
5 luftë në regjionin e Rugovës.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa e keni kuptuar ju, ku
7 e gjeti ai autoritetin që t'ju intervistonte, t'ju merrte në
8 pyetje, mbase është fjala më e duhur? Mbi ç'bazë e bëri ai
9 këtë?

10 PË. I vetmi i njeri asokohe që kishte një uniformë ushtarake
11 dhe ishte armatosur, komplet. Dhe lëvizke i lirë, edhe në
12 Deçan edhe në të gjitha zonat, tuj e dit që i vetmi ishte [E
13 pakuptueshme], a ne s'kemi dit hala që kemi pa as uniformën e
14 aty te ai e kam pa që uniforma e Ushtrisë Çlirimtare të
15 Kosovës. Ka qenë fillimi, ka qenë herët.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është i drejtë
17 parashtrimi im se ti atëherë ke menduar që s'kishte zgjidhje,
18 thjesht duhet ta respektoje kërkesën që të bënë për t'u marrë
19 në pyetje? S'kishte çbëje.

20 PË. Po patjetër, unë e njifsha personin, edhe patjetër une
21 shkova. Po duhet ta shkoj, a bën? A bën?

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

23 PË. Unë kam qenë në vitin 1993 i dënuar me pesë vjet burg për
24 formimin e Ministrisë së Mbrojtjes në komunën e Deçanit. Në
25 1996 jam dal, edhe Faton Mehmeti në shtëpinë time për gazetën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rrustem Tetaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 61

1 Zgjimi, ekziston, që është ardh ai si gazetar me më pyt
2 qëndrimet e mia dhe ma së shumti më ka pyt, edhe ekzistojnë
3 aty, për Rugovën. Por atëherë nuk e kam dit. Edhe çdo pyetje
4 që ma bojke në lidhje me Presidentin Rugova, që e kisha idol,
5 që e kisha President, që isha ushtar me plot kuptimin e plotë
6 të institucioneve të Kosovës, ai me qëllim të caktum më ka
7 ardh në shtëpi dhe fillimi dhe drejtimi që nuk ka mujt me më
8 laku nga rruga e drejtë e Ibrahim Rugovës, atëhere në fillim
9 të luftës qe me uniformën, u bo dikushi edhe po më ka marrë në
10 bisedë informative. Në cilësinë e kujna, si nuk e di.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.
12 Kaq pyetje kisha unë.

13 DËSHMITARI: Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
15 Gaynor.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Më falni që ju ndërpreva. Mund të më
17 ndihmojë Gjykatës Mettraux për referencën për pyetjen që bëri
18 në transkriptin në faqen 54. Ju thatë, e pyetët:

19 "Keni diskutuar dhe keni parë një listë personash me
20 Faton Mehmetaj."

21 Do të doja ku e keni referencën për këtë, sepse unë
22 kuptova thjesht diskutim jo që "e ka parë".

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshmitar, më dëgjoni pak.
24 Dëshmitar, më dëgjon?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Lista, lista --

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- lista e personave që
4 diskutova [Sipas përkthimit] me Faton Mehmetaj, këtë listën ti
5 dhe e ke parë apo thjesht e ke diskutuar? Ja ke parë ti listën
6 me sytë e tu?

7 PË. Jo, e kam diskutuar me të, më mënyrë kështu.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Dhe
9 faleminderit Avokatit për pyetjen.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Dëshmitar, edhe unë kam
11 disa pyetje për ju. Pyetja e parë lidhur me numrin e nënzonave
12 në Rrafshin e Dukagjinit që u krijuan në atë takim ku keni
13 marrë pjesë dhe ju në fund të majit 1998.

14 Dje Prokurori të tha:

15 "Gjatë këtij takimi, ti ke qenë personi që propozove që
16 ta ndaje zonën në katër nënzona. Kështu?"

17 Dhe ti the:

18 "Po, kështu."

19 Të kujtohet dje kjo pyetje-përgjigje?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në deklaratën TPNJ-në, që
22 mban numrin P1595, në faqen 10, po ua lexoj pjesën përkatëse,
23 ke thënë, lidhur me këtë takim në fund të majit 1998, ke
24 thënë:

25 "Vendosa të flisja dhe të shpjegoja se zona e Gllogjanit,

1 shtabi i UÇK-së duhet ndarë në pesë zona operative. Numri 1
2 deri në 5. Dhe propozova që të bëhej Ramush Haradinaj
3 komandant i zonës 1 ... dhe të kishte katër komandantë të
4 tjerë për zonat e tjera dhe secili do të ishte përgjegjës për
5 nënzonën e vet. Më pas është dhënë shpjegime për zonën numër
6 2, 3 dhe 4.”

7 Po ju keni thënë 5 nënzona. Tani unë e kam pak të
8 paqartë, duke marrë parasysh deklaratën që ke dhënë për ish-
9 Tribunalin, a ka pasur 4 apo 5? A na e shpjegoni pak, ju
10 lutem, që ta kuptojmë. A ka pasur 4 apo 5 nënzonat për të
11 cilat u vendos në atë takim?
12 PË. Faleminderit. Por do të përpjekna. Në takimin në
13 Gllogjan, për ndarjen e zonave e unë jam ai që e kam diskutue,
14 sigurisht ka edhe procesmbajtës, por si shtab të Gllogjanit e
15 kemi caktue, të përgjithshëm të Gllogjanit, përpara
16 Gllogjanit, e kam diskutu edhe përpara, ka qenë Ramush
17 Haradinaj, njëherit edhe komandant i zonës numër 1.

18 Zona 2 e ka pas komandant Shemsedin Çekaj. Zona 3, jam
19 kon Rrustem Tetaj. Zona ishte që e ndajke lumi i Lumbardhit,
20 tash po quhet, përpara Bistrica e Deçanit, ishte Isniqi. Edhe
21 n'atë zonën 4 ishin Skënder Rexhahmetaj, edhe si zëvendës Gani
22 Gjykaj. Por, Zona 5, që është nda, ka qenë neutrale dhe ajo se
23 për shkak të afërsisë të forcave serbe në komunën e Deçanit,
24 në qytetin e Deçanit. Edhe ajo ka qenë nën komandën a Adem
25 Ukhaxhahit. Është fakt që janë kon dhe kam detyru edhe janë.

1 Po këtu u përmend tri - e u nalsha aty ku jam konë une, nuk
2 shkova me tutje me shpjegue dje këto gjëra. Është fakt që kanë
3 ekzistue pesë.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Që ta kuptojnë palët e
5 tjera, për faktet e gjykuara në seanca të mëparshme me numër
6 256. Është në paragrafin 58(e) i aktgjykimit të 29 nëntorit
7 2012 në ish-Tribunalin e Hagës.

8 Dëshmitar, ne kemi këtë informacion, që nënzona 5 është
9 drejtuar nga Adem Ukë Haxhaj - Haxhiaj --
10 PË. Drejtë.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] -- ju kërkujmë ndjesë për
12 shqiptimin, dhe kishte fshatin Carrabreg, Voksh dhe Drenoc në
13 Depan, në bashkinë -- në komunën e Deçanit, kështu?
14 PË. Saktë.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

16 Dje në një nga përgjigjet që i dhatë Avokatit të Thaçi,
17 ju thatë:

18 "...nëse dikush e dinte, do ta dinte që ka ekzistuar
19 Shtabi i Përgjithshëm që atëherë unë do ta kisha pasur më të
20 lehtë që të flisja dhe të jepja dëshmi para jush. Komandanti
21 Ramush Haradinaj nuk e ka ditur që ka ekzistuar një shtab i
22 tillë i përgjithshëm, ose mbase e ka ditur dhe s'e ka pranuar
23 asnjëherë."

24 Kjo ë diskutuar në kuadër të një takimi që është mbajtur
25 më 20 gusht 1998.

1 Tani i lutem Sekretarit të seancës që të vendosë në ekran
2 materialin 2D026.

3 Do shohim në ekran një dëshmitar - në ekran, Dëshmitar,
4 një dokument që ua tregoi dhe Avokatja e z. Veseli.

5 SPOE225760 [Sipas përkthimit], ju lutem.

6 Këtë dokument e keni parë dhe më përpara, Dëshmitar. E
7 shihni që është i nënshkruar nga Ramush Haradun - Haradinaj.
8 Shkojmë më poshtë në tekst. Data është 2 korrik 1998.

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shohim që Ramush Haradinaj
11 ja ka dërguar këtë dokument arkivës dhe Shtabit të
12 Përgjithshëm të UÇK-së dhe askujt tjetër. E shihni?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shohim pak më lart
15 anglishten. Dokumenti thotë, e lexuam dhe sot:

16 "Ju njoftojmë se në mbledhjen e datës 23 qershor 1998 në
17 Jabllanicë, u zgjodhën Komandanti i Shtabit Operativ të
18 Rrafshit të Dukagjinit, Zëvendëskomandanti, Kryeshefi i
19 Shtabit, Zëvendëskryeshefi i Shtabit."

20 Dëshmitar, sipas meje, siç e kuptoj unë, mua më duket se
21 z. Haradinaj është bashkëpunues me Shtabin e Përgjithshëm,
22 duke i dërguar një njoftim të këtij lloji, edhe me siguri që e
23 ka ditur që ekzistonte një organ me emrin Shtabi i
24 Përgjithshëm. E kam kuptuar unë drejt këtë dokument sipas
25 jush?

1 PË. Nëse i referohet këtij dokumenti, është e logjikshme
2 ashtu me mendu. Por, rrethanat në terren në qoftë se ka
3 ekzistue na nuk kemi pas nevojë me ardh deri te FARK-u dhe
4 Forcat e Armatosura të Kosovës dhe te UÇK-ja si fërkim në atë
5 kohë, se m'u pa nis Shtabi i Përgjithshëm të Ushtrisë
6 Çlirimtare të Kosovës prej fillimit, atëherë s'kemi pas nevojë
7 këto gjëra me i diskutu. Por, na u duhte na me marrë
8 iniciativa vetë tonat se ç'ka me bo ma tutje. Edhe të gjithë
9 ushtaria e asaj, ushtarët që ishin vullnetarë të gjithë
10 pritshin prej neve, prej komandantëve që ishim më të angazhuar
11 që ç'ka, qysh me veprue.

12 Prandaj, edhe një herë po them, në qoftë se i referohemi
13 këtij dokumenti është e logjikshme, shoku Gjykatës, por unë
14 jam i besueshëm që Ramush Haradinaj edhe nëse ka ndëgju ka
15 ndëgju shumë vonë pas rastit kur e ka marrë komandanti i
16 Rrafshit të Dukagjinit në Zhebel se përndryshe, sa e njoh unë
17 Ramush Haradinin, edhe si ushtar edhe si njeri, nuk besoj që
18 ka mujt mos me na njoftue neve se ekziston Shtabit të
19 Përgjithshëm i Rrafshit të Dukagjinit - Shtabi i Përgjithshëm
20 i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Shtabi ka ardh shumë vonë.
21 Shumë vonë.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ta them me një pyetje shumë
23 të thjeshtë. A e pranoni se në momentin kur e ka nënshkruar
24 këtë, Ramush Haradinaj do ta ketë ditur medoemos se ekzistonte
25 kjo gjë që quhej Shtabi i Përgjithshëm? E pranoni këtë?

1 PË. Më falni, pak ma nalt a mundeni me e çu? Veç ta di edhe
2 datën e dokumentit, datën [E padëgjueshme]. Ah po, po shoh,
3 versionin në anglisht, 02.07. Ky dokument, mendoj, po --

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] I lutem Sekretarit që ta
5 zvogëlojë pak dokumentin që të duket i gjithi.

6 Ja, sipër e ka datën, 2 korrik 1998. Dhe në fund po
7 kështu thotë, 2 korrik 1998.

8 PË. Veç mua po ma merr mendja që q'ky dokument është bo shumë
9 ma vonë, po e kanë shkruar, në këtë kontekst e kanë shkruar
10 02.07, se i kam pa edhe shumë të tjera dokumente, që e
11 përfshijke Rrafshin e Dukagjinit, por me shkrime dhe me
12 vendime kishin datat e mbrendshme a në dokument ishin shumë ma
13 vonë. E për atë jam i bindur që Ramush Haradini nuk ka qenë në
14 dijeni në atë kohë është fjala, për atë kohë.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po a mund të na jepni ndonjë
16 shpjegim përse Ramush Haradinaj e paskësh bërë një dokument të
17 tillë më mbrapa, më vonë edhe i ka vënë datën 2 korrik 1998?

18 PË. Jo Rramushi. Jo Ramushi. Këto dokumente i ka shkru
19 tjetërkush. Edhe iu kanë afrue në ato momente të luftës [E
20 pakuptueshme] nuk ka pas kohë ai me kqyr data qysh është, po i
21 ka pëlqy edhe e ka dhënë.

22 Kështu është mendimi im. Se ai arsye s'ka pas me bo, o
23 fjala për Ramushin, me bo, me shkru dokumenta përmas edhe me
24 data të përparshme. Po bindja jeme është ashtu, që dokumenti
25 është shkru shumë ma vonë, e data është shkru gjatë 2

1 korrikut. Se sikur të ish kon me 2 korrik, e kisha dit edhe
2 unë, edhe po figuron emni jem. Nuk është veç i Ramushit këtu,
3 po jam edhe une. E unë vetë, zëvendës, është fakt që jam kon
4 zëvendës i Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit,
5 Kryeshef e kam pas Sali Veselin, që këtu nuk po figuron - po,
6 po figuroj, po. Po. Edhe une mos me e dit.

7 Po këto me qëllime të caktume janë shkru shumë ma vonë
8 edhe me data të mahershme. Qysh është e mujshme mos me e dit
9 unë, mos me i pa këto une në shtab. Edhe s'kam arsye pse mos
10 me thanë jo. bile mburrna, mburrna që ekziston emri këtu:
11 Zëvendëskryeshef i Shtabit Operativ të Dukagjinit, sepse isha.
12 Edhe kam q'atë, të njëjtin post. Edhe s'kam arsye pse me
13 vazhdue ma tutje derisa ekziston emri im.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të kaloj në një gjë
15 tjetër tani. Ka të bëjë me periudhën pas mbledhjes në Zhabel,
16 Zhebel. Dje u fol për këtë në faqen 120 të transkriptit
17 paraprak. E them këtë për palët e tjera. Keni thënë dhe po
18 citoj që:

19 "Shtabi i Përgjithshëm me - pas mbledhjes, pra me urdhër
20 të tyre, pra me urdhër të tij, të shtabit, pas mbledhjes në
21 Zhebel, kanë ushtru presion të të gjitha formave që forcat e
22 FARK-ut të mos ekzistonin më dhe të ekzistonte veç UÇK-ja."

23 Ju kujtohet që e keni thënë këtë dje?

24 PË. Po, drejtë.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po më intereson me dit diçka

1 më shumë lidhur me atë se ç'ka kishit në mendje kur i keni
2 thënë këto fjalë që Shtabi i Përgjithshëm "ka ushtru presion
3 të të gjitha formave që forcat e FARK-ut të mos ekzistojshin
4 më". Mund ta shpjegoni pak më gjatë se ç'ka kishit ndërmend
5 kur i thatë këto fjalë?

6 PË. Disponimi i të gjitha fshatrave dhe struktura të ushtrive
7 dhe shtabeve të Rrafshit të Dukagjinit ishte me ardhjen e
8 forcave të FARK-ut që Tahir Zemaj të ishte komandant. Edhe ajo
9 u bo. Mirëpo, dikujt s'i pëlqej edhe u bo takimi në Zhebel.

10 Edhe na i danë kuvertat, zarfat me urdhëresa se secili me
11 pas funksionin. Për atë kam thon.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po forma të tjera presioni
13 kishte që të mos ekzistonin më forcat e FARK-ut? Pra, kishit
14 forma të tjera të presionit në mendje kur i thatë këto fjalë?

15 PË. S'më kujtohet kujtohet për momentin, s'po mund, s'po di.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Unë këto pyetje
17 kisha. Faleminderit shumë, z. Dëshmitar.

18 Faleminderit, z. Kryegjykatës.

19 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
20 pyetje plotësuese z. Quick?

21 Z. QUICK: [Përkthim] Jo.

22 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë pyetje
23 nga Avokati i Mbrojtjes i Thaçit?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, faleminderit, z. Kryetar.

25 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic:

1 Z. MISETIC: [Përkthim]

2 PY. Mirëdita sërish, z. Dëshmitar.

3 PË. [E padëgjueshme].

4 PY. Disa pyetje plotësuese lidhur me pyetjet që jua kanë bërë
5 anëtarët e Trupit Gjykses. Së pari një pyetje për listat për
6 të cilat iu bënë pyetje Gjykatësi Barthe dhe Gjykatësi
7 Mettraux.

8 Dëshiroj t'ju lexoj diçka që ju keni thënë në gjykimin
9 kundër Haradinajt dhe t'ju pyes nëse i qëndroni asaj dëshmie
10 edhe sot.

11 Për palët është IT-04-84, T3597 deri në T3689, faqen
12 3671, rreshtat 15 deri në 22.

13 Dhe ju keni thënë kështu që:

14 "Unë nuk e pyeta, por përpara se të vinte Togeri ishim
15 përpilu ca lista në disa fshatra. Këto lista janë përpilu për
16 disa arsye -- për arsye personale. Janë lista me i kompromentu
17 njerëzit, por nuk janë lista të përpiluara nga Togeri. Janë
18 përpilu nga persona të tjerë po ja kanë ngarku sikur i ka
19 përpilu Togeri. Nuk po them se këto i ka bo Ramushi, por në
20 disa fshatra kishte njerëz që ishin anëtarë të partive të
21 ndryshme dhe kishin dallime politike mes njëri-tjetrit, dhe me
22 shumë gjasë kjo do ketë qenë edhe arsyeja pse kanë ekzistuar
23 këto lista."

24 A keni thënë në -- pra, a është -- a keni thënë kështu në
25 gjykimin kundër Haradinajt dhe ai qëndroni kësaj dëshmie edhe

1 sot?

2 PË. Në qoftë se ekziston dokumenti që është një kohë më e
3 largët, atë që e kam thonë edhe sot do i qëndroj. A sot me më
4 vet për ato, tash mundna me gabu se nuk kam mujt me i majt
5 mend të gjitha.

6 PY. Pra, ju rikujtohet ç'ka keni dasht me thënë kur keni
7 thënë që nëpër fshatra kishte njerëz që ishin anëtarë të
8 partive politike dhe kishin dhe dallime politike me njëri-
9 tjetrin? E dini për çfarë e kishit fjalën kur i keni thënë
10 këto fjalë?

11 PË. Po, ishte që para lufte ishin partitë të formuara dhe
12 ishin në një konkurrencë partiake, pluralizëm, politik të asaj
13 kohe, për hir të pluralizmit, xhelozisë, mund të jetë që janë
14 bo. Ose kam thënë. Kjo është arsyeja ime ç'ka po mendoj tashti
15 për atëherë.

16 PY. Dhe krijimi e këtyre listave mendoni se ka ardh për shkak
17 të xhelozive dhe këtyre rivaliteteve, konkurrencës politike
18 nëpër fshatra? Ju kam kuptuar saktë për këtë që thatë tani?

19 PË. Po.

20 PY. Keni dëshmuar, po kështu e thatë dhe sot më duket se këto
21 lista janë kriju veç në fillim, ke përdorur fjalën "fillim".
22 Kur thoni "fillim" e keni fjalën për periudhën kohore përpara
23 krijimit të nënzonave?

24 PË. Po.

25 PY. Nënzonat janë krijuar në fund të majit 1998, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Pra, kur thoni që ka pas lista, këto duhet të jenë lista
3 të cilat me siguri do jenë përpiluar përpara fundit të majit
4 të vitit 1998, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe po thoni se kjo është periudha kohore kur ju thoni se
7 nuk ka pasur organizim dhe kaos ka qenë, kështu?

8 PË. Fakt.

9 PY. Tani një temë tjetër, diçka tjetër. Ka të bëjë me rolin e
10 z. Mehmetaj.

11 Gjykatësi Mettraux ju bëri disa pyetje sa i takon
12 emërimin të z. Mehmetaj si përfaqësues politik në gusht 1998.
13 T'i ndjek -- do ndjekim renditjen kohore të emërimeve të tij
14 dhe do t'ju bëj disa pyetje.

15 Dje ju treguan një dokument.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe ju lutem që ta nxjerrim këtë
17 dokument prapë në ekran. Pra, është dokumenti U001-4078.

18 PË. [Kollitet] Më falni.

19 PY. Janë vendime. Është një dokument ku janë regjistruar
20 vendime të marra në mbledhjen në Jabllanicë në 23 qershor
21 1998.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Po të tregojmë pjesën e poshtme të
23 dokumentit në ekran, thuhet - pra në mes të faqes:

24 "Pasi u vunë në pah nga të pranishmit të gjitha
25 përparësitë e bashkimit të forcave, u vendos unanimsisht dhe u

1 shpall unanimitisht themelimi i Shtabit të Rajonit të Dukagjinit
2 me këtë përbërje.”

3 E shihni?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe një prej personave i cili ka marrë vendim unanimitisht
6 për emërim si përgjegjës për shërbimin informativ është Faton
7 Mehmetaj. Është kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Është e vërtetë atëherë se ai emërimin e ka marrë në bazë
10 të kësaj mbledhjeje lokale, në nivel lokal dhe në bazë votimit
11 ku është vendos unanime që të merrte këtë post në zonën e
12 Dukagjinit?

13 PË. Po.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, kërkoj që të pranohet
15 ky dokument në prova gjyqësore.

16 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
17 kundërshtim?

18 Z. QUICK: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Kërkoj ndjesë përpara se të
20 pranohet prova gjyqësore. Mendoj se ka një mospërputhje midis
21 versionit anglisht dhe shqip sa i takon rolit të Faton
22 Mehmetajt. Se thuhet informativ dhe thuhet inteligjence.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse është problem përkthimi midis
24 dy dokumenteve mbase duhet korrigjuar.

25 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rrustem Tetaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 74

1 procedurë që mund të ndiqet për korrigjimin.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Po mund ta shënojmë për
3 identifikim.

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër,
5 kështu, do ta shënojmë për identifikim tani në pritje të një
6 përkthimi ose një zgjidhje të problemit të mundshëm në
7 përkthim.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti
9 U001-4078 deri në U001-4080 bashkë me përkthimin në anglisht
10 shënohet për identifikim si provë materiale 1D00188, me
11 regjistrimin konfidencial.

12 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kështu do e
13 lemë.

14 Z. MISETIC: [Përkthim]
15 PY. Tani, Dëshmitar, dëshirojmë që t'ju tregojmë provën
16 materiale P01386, ju lutem.

17 Dëshmitar, ju kujtohet që e keni parë më përpara këtë
18 dokument?

19 PË. A bon pak ma nalt me e çu me e pa komplet. Mund të jetë.
20 nuk jam i sigurt.

21 PY. Dokumenti mban datën 13 [Sipas përkthimit] korrik 1998
22 dhe sipas këtij dokument, autorizon Ramush Haradinajn e Faton
23 Mehmetajn, si oficer i shërbimit të zbulimit, që të ndërtojë
24 strukturën e zbulimit të UÇK-së në nënzonën e përgjegjësisë të
25 shtabit operativ të Rrafshit të Dukagjinit.

1 Pajtoheni me mua që 13 [Sipas përkthimit] korriku 1998 ka
2 qenë periudha kohore kur Ramush Haradinaj punon së bashku me
3 oficerët që kishin ardh prej FARK-ut?

4 PË. Po.

5 PY. E kam të saktë që kjo tregon se ishte Ramush Haradinaj ai
6 i cili e ka emëruar Faton Mehmetajn në postin -- në këtë
7 pozitë, pra, në shtabin operativ të zonës së Dukagjinit?

8 PË. Kjo është e vërtetë se po shihet edhe nënshkrimi i
9 Ramushit edhe vendimi i Ramushit po unë e thashë edhe përpara,
10 të paktën edhe një dilemë që qëto data, këto dokumenta janë
11 shkruar ma vonë në mënyrë që me mbet ma herët. Me ma herët,
12 janë shkruar ma vonë e ma data të hershme. Ashtu po e kuptoj
13 unë.

14 PY. Ju ka bërë pyetje Gjykatësi Mettraux në lidhje me
15 emërimin e Faton Mehmetaj si përfaqësues politik më 13 gusht
16 1998. Besoj se ju e keni cekur këtë edhe në intervistën tuaj
17 me Prokurorinë këtu. Dua që të lexoj, t'ju lexoj se çfarë
18 thotë z. Mehmetaj për këtë emërim dhe t'ju bëj disa pyetje
19 lidhur me versionin që ai jep se ç'ka ndodhur.

20 Për palët kjo është 056292 Pjesa 5, faqja 19.

21 PY. Z. Mehmetaj -- z. Mehmetaj i është bërë pyetje:

22 "Nuk është bërë emërim publik për ju si -- në drejtorinë
23 politike?"

24 Ai është përgjigjur:

25 "Po, në drejtorinë politike.

1 "PY. E kur ka ndodh kjo?

2 "PË. Në gusht 1998.

3 "PY. Na tregoni se si ka ndodhur kjo?

4 "PË. Nasim Haradinaj dhe Jashar Salihu më pa propozuar në
5 këtë pozitë si shef i drejtorisë politike.

6 "PY. Ju propozoi -- kujt ia propozoi këtë?

7 "PË. Shtabit të Përgjithshëm. Kam dëgjuar për emërimin
8 tim në lajme. Askush nuk më ka pyt. Herën e parë që kam
9 dëgjuar për këtë ishte kur është transmetu në Radio
10 Televizionin e Kosovës. Nuk më është -- nuk jam kontaktuar
11 kurrë nga Shtabi i Përgjithshëm gjatë kësaj periudhe. Nuk kam
12 komunikuar kurrë me Shtabin e Përgjithshëm në pozitën e
13 përfaqësuesit politik në -- Ramë Buja ka shkuar në Rambuje në
14 vendin tim. Kjo është historia.

15 "PY. Po kur e morët vesh që Nasim Haradinaj ju kishte
16 propozuar juve në Shtabin e Përgjithshëm?

17 "PË. Kam pyt edhe kur kam nigju për emrin tim.

18 "PY. Kur është shpallur?

19 "PË. Po.

20 "PY. Dhe ju -- atëherë Ramush Haradinaj a kishte dhënë
21 pëlqimin e tij për emërimin? Ai a pajtohej dhe ai?

22 "PË. E kam dëgju për emërimin tim njësoj, ka dëgju
23 domethënë në të njëjtën mënyrë si unë, në lajme. Më tha "Urime
24 për emërimin si përfaqësues politik". Kështu ka ndodhur.

25 "PY. Pra, e pyetët ju Haradinaj nëse ai --

1 "PË. Në atë kohë ai ishte në Suedi.

2 "PY. Pra, ai ju ka emëru prej Suedisë? A ju ka propozu
3 prej Suedisë?

4 "PË. Po."

5 Tani, pyetja që unë kam për ju është kjo: Haradinaj dhe
6 Jashar Salihu -- pikësëpari e dinit se kush ishte Nasim
7 Haradinaj?

8 PË. Po.

9 PY. Kush ishte ai?

10 PË. Është një kushëri i afërt i Ramush Haradinaj, edhe i
11 fshatit Gllogjan.

12 PY. Po Jashar Salihu, e dini kush ishte?

13 PË. Po.

14 PY. Kush ka qenë Jashar Salihu?

15 PË. Njëri një atdhetar, një intelektual, një kombëtar, në të
16 gjitha virtytet që ka pas. Edhe ai ka qenë nga fshati Batushë
17 a Mulliq, mos -- Batushë. Jo Batushë. Batushë.

18 PY. Fshati Batushë është në zonën e Dukagjinit?

19 PË. Po.

20 PY. Nasim Haradinaj në Suedi jetonte asokohore?

21 PË. Po, qysh herët.

22 PY. Po Jashar Salihu ku ka qenë ai në këtë kohë, nëse e dini?

23 PË. Në Zvicër.

24 PY. Pra, a do të kishit arsye kundërshtu, pra këtë histori,
25 këtë version që ka dhënë z. Mehmetaj se si është -- domethënë,

1 si ka ardh puna që ai ka qenë në Deklaratën Politike nr. 7?

2 PË. Shumë e thjeshtë. As Jashari, as Nasimi nuk ka qenë në
3 Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e si
4 munden ata të dy me e propozu një njeri me qenë në q'atë
5 funksion që e ka thonë Faton Mehmeti.

6 PY. Ne këtë sigurisht mund ta dikutojmë. Kanë qenë të -- kanë
7 qenë të njohur në diasporë apo jo?

8 PË. Ata të dy? Po.

9 PY. A mos kanë qenë kështu persona që siguronin dhe fonde në
10 -- për atë -- në fondin që -- Vendlindja Thërret.

11 PË. Vendlindja Thërret, po. Masandej e kam dëgjue që ka qenë
12 kryshef, a si e qujtët ju të fondit Vendlindja Thërret, Jashar
13 Selimi, me gjithë këta. Jashar Selimi ka qenë. A për Nasimin
14 nuk e di që ka qenë i angazhuar për fonde. A për Jasharin, po.

15 PY. Po nuk keni arsye me e kundërshtu këtë që e ka thënë z.
16 Mehmetaj, që ai nuk ka pas asnjë kontakt me Shtabin e
17 Përgjithshëm pos faktit që i është përmend emri, i është cek
18 emri në Deklaratën Politike Nr. 7, apo jo?

19 PË. S'kam unë, se s'kam komunikue. S'kam fakt që ta
20 kundërshtoj. Mund të jetë një gjë e tillë.

21 PY. Gjykatësi Mettraux ju tregoi një dokument të datës 15
22 nëntor të vitit 1998. Ju atë kohë e kishit lëshu Kosovën me
23 datën 8 shtator 1998, kështu?

24 PË. Jo, s'është e vërtetë.

25 PY. Po kur jeni largu?

1 PË. Unë jam -- nga Kosova personalisht na e kemi lëshue me
2 grupin që -- me urdhër të -- që e kam fol me forcat e [E
3 padëgjueshme] qenë në koncentrumë, Ushtria Çlirimtare e
4 Kosovës në Prapaqan, jemi largue zona e amë datën 8. Mirëpo na
5 jemi vendos në bjeshkë të larta dhe në Rugovë. Deri në fund
6 unë kam ekzistue [E padëgjueshme] fund të nëntorit. Ose gjysa
7 e nëntorit ka qenë kur unë jam largu për shkak të sëmundjes
8 time që e kam pas. Unë kam qenë në zonë. Edhe ajo është zonë e
9 Dukagjinit edhe ai -- zonën e luftës e kam [E padëgjueshme]
10 kur dhe kam qenë.

11 PY. Po, por kur jeni kthi pastaj?

12 PË. Nuk jam kthi.

13 PY. Faleminderit. Faleminderit për përgjigjet në pyetjet e
14 mia.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Znj. O'Reilly.

18 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Një pikë shumë të shkurtër e
19 kam.

20 Ju lutem të nxjerrim në ekran dokumentin P1598, në ekran
21 si në anglisht ashtu dhe në shqip.

22 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj.

23 O'Reilly:

24 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

25 PY. Ndërkohë që na e nxjerr Sekretari në ekran, z. Tetaj, ju

1 kujtohet një person me emrin Emresh Xhemajli - siç e dëgjoi
2 përkthyesi?

3 PË. A duhet të pritët diçka në ekran?

4 PË. Jo, jo. A ju kujtohet ky person?

5 PË. Po.

6 PY. Ju kujtohet se çfarë nofke e ka pas?

7 PY. Gjatë -- unë shumë pak e kam takue, qysh herët në
8 fillimin e luftës në fshatin Gllogjan. Nofkën me sa duket e ka
9 pas Kompjuteri.

10 PY. Po.

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Ju lutem të shohim faqen e
12 fundit të këtij dokumenti në anglisht dhe në shqip. Deri në
13 fund fare.

14 PY. Ju z. Tetaj e shihni se, se, se Kompjuteri, e shihni
15 fjalën Kompjuteri me inicialet E.XH., është autori i këtyre
16 shënime të shkruara me kompjuter. E shihni?

17 PË. Po.

18 PY. Pra, z. Emrush Xhemajli, ndryshe i quajtur Kompjuteri,
19 ishte, ishte po kështu në zonën e Dukagjinit që ishte në
20 gjendje që të shkruante me makinë dokumente shpesh, përfshirë
21 këtu dhe procesverbale të mbledhjeve, apo jo?

22 PË. Mund të jetë.

23 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

24 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
25 znj. O'Reilly.

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Edhe unë s'kam gjë.

2 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, vetëm dy pyetje, i nderuar
4 Gjykatës.

5 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, lejohet.

6 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis:

7 Z. ELLIS: [Përkthim]

8 PY. Ka të bëjë me Faton Mehmetaj dhe me listat, listat e
9 zeza. Ju bënë -- iu bëri pyetje Prokuroria për këtë në shkurt
10 të vitit të vitit 2020. Por lexoj Pjesën 4 të intervistës tuaj
11 me numër 074659 [Sipas përkthimit], Pjesa 4, faqja 9, rreshti
12 4. Po jua lexoj:

13 "Lista e zezë siç e dini, Faton Mehmetaj nuk është se e
14 kam parë që Fatoni ta ketë listën vetë. Është thjesht që e kam
15 parë diçka. Nuk e di -- nuk e kam parë që ta ketë listën
16 Fatonin. Dua që të mirëkuptohet kjo."

17 Kështu i keni thënë ZPS-së, më falni, Prokurorisë në
18 shkurt të vitit 2020.

19 PË. Edhe sot e kam thonë. Edhe kjo ishte pyetje që e kam -- e
20 fola gjatë ditës. E njëjta përgjigje.

21 PY. Faleminderit. Ju pyetën gjithashtu kush e ka përgatitur
22 këtë listë. Në Pjesën 3 të intervistës suaj, faqja 22, rreshti
23 6, ju keni thënë:

24 "...nuk jam i sigurt, se unë nuk e kam parë vetë me sytë
25 e mi që t'i përgatiste lista."

1 I qëndroni ende kësaj dëshmie sot?

2 PË. Po.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam më pyetje.

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Tetaj, përfunduat dëshminë tuaj. Nuk ka më pyetje për
6 ju. Tani mund të largoheni nga salla e gjyqit. Faleminderit që
7 erdhët. Faleminderit që na dhatë dëshminë tuaj. Ju urojmë
8 gjithë të mirat.

9 DËSHMITARI: A mundna me i fol?

10 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk
11 mundeni. Jo, faleminderit. Dëshmia juaj përfundoi.

12 DËSHMITARI: Për shkak të opinionit, po nejse...

13 [Dëshmitari largohet]

14 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shihemi të
15 hënë në orën 09.00. Faleminderit të gjithëve.

16 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

17 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 --- Seanca mbyllet në orën 12.33

19

20

21

22

23

24

25